



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK MBIKËQYRËS NGA KOMISIONI I KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR EKONOMI, INDUSTRI,
NDËRMARRËSI DHE TREGTI, MBAJTUR MË 3 PRILL 2024**

**SA NADZORNE JAVNE RASPRAVE KOMISIJE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA ZA EKONOMIJU, INDUSTRIJU, PREDUZETNIŠTVO I
TRGOVINU, ODRŽANE 3. APRILA 2024. GODINE**

**PRILL - APRIL
2024**

Dëgjimin publik e drejtoi kryetari i Komisionit, z. Ferat Shala.

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm në këtë takim, po fillojmë këtë takim të përbashkët të thirrur nga Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me të vetmen pikë të këtij dëgjimi publik, sfidat në zbatimin e legjislacionit nga institucionet ligj zbatuese dhe ndërmarrjet publike në sektorin e shërbimeve të ujit.

Të nderuar të pranishëm, ne si komision kemi pasur në plan dhe kemi në plan monitorimin edhe legjislativ edhe operativ të këtij sektori dhe nisur nga ajo që jemi dakorduar me kolegët deputetë, ne sot ju kemi ftuar dhe faleminderit për pjesëmarrjen të gjithë ata që i kemi planifikuar dhe i kemi ftuar praktikisht janë prezent, jam mirënjohës shumë. Sektori i ujërave është njëri nga sektorët vital të shoqërisë tonë në të cilën ne si komision në kontinuitet kemi përcjellë aktivitetet, monitorimet edhe të ligjit, por edhe të disa sektorëve apo ndërmarrjeve, rregullatorin po ashtu e kemi në kombinim të plotë rregullativ dhe ne si komision kemi ngritur disa shqetësime do të thotë mbështetur në punën që e kemi pa. Unë po i përmendi vetëm shqetësimet si fazë fillestare apo hyrëse, pastaj ne do të bashkëbisedojmë bashkërisht për të gjetur alternativat, mundësitë, idetë, propozimet, për të dhënë rekomandimet eventuale që ne si komision apo si ligjvënës të shohim çka mund të bëjmë në përmirësimin e këtij sektori në tërësinë e tij si në kuptimin legjislativ, operativ, në kuptimin e cilësisë së ujit dhe të shërbimeve tjera.

Andaj edhe një herë ju falënderoj duke ngritur shqetësimet që komisioni ka pa, do të thotë funksionimin jo të mjaftueshëm të sektorit, performancën e kompanive rajonale, cilësinë e shërbimit të ujit, bazën juridike dhe realizimin e tij, pastaj çështjet e harmonizimit dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave e kështu me radhë, por normalisht edhe çështjen e një tërësie institucionesh të cilat merren me çështjen e sektorit të ujit, tërësi e cila realisht mendoj që ne duhet ta shikojmë a jemi në harmoni me kërkesat, me nevojat, me atë çfarë realisht qytetarët tanë e kërkojnë.

Ju premtoj që komisioni përkundër përbërjes politike që ka në sektorin e ujit kemi pasur dhe kemi një dakordanc të plotë për të ndihmuar dhe gjetur alternativat më të mira në shërbim të qytetarëve të vendit. Unë para se t'i kaloj fjalën koleges, nënkryetares, pastaj ju secilit nuk do ta zgjatim ne shumë sot, sepse jemi shumë të vullnetit të ju dëgjojmë ju më shumë, secilin nga ju, faleminderit edhe zëvendësministrit që është këtu, një përshëndetje edhe pse të gjithëve po ju përshëndes njëzëri kështu mos t'i dallojë të gjithëve, përfaqësuesja ... është pjesë e jona gati. Pa dashur shumë me elaboruar situatën unë po ju kërkoj që të jemi sa më eficient në çështjen e diskutimeve se edhe ashtu nga numri jemi mjaftueshëm shumë, edhe pastaj koha mund të na shkojë shpejt.

Po ashtu kërkoj për shkak të transparencës dhe procesverbaleve që secili që merr fjalën të prezantohet me emër dhe me institucionin që përfaqëson pozitën që ka, komisioni do të nxjerrë pastaj rekomandimet, sugjerimet që dalin nga kjo dhe sigurisht do të veprojmë pastaj në një takim të radhës me këtë temë ose me këto qëndrime që dalin nga ky takim i përbashkët. Pa dashur me zgjatë fjalën po ia kaloj nënkryetares së komisionit, urdhëro deputete.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar përfaqësues të institucioneve,

I nderuar zëvendësministër,

E nderuara drejtoreshë ... ,

Të nderuar përfaqësues nga KRU të ndryshme, përfaqësues brenda sektorit, gjithashtu edhe institucione tjera mbikëqyrëse qoftë nga njësjia, qoftë nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Siç e përmendi edhe kryetari për neve si komision ka qenë në fokus të vazhdueshëm ngritja e performancës brenda sektorit të ujërave në kuadër të gjithë komponentëve të saj, si në kuadër të aspektit ligjor pra në rrethana të zbatimit të ligjit, mirëpo dhe nevojës që të ketë plotësim ndryshime ose adresim të nevojave se aty ku duhet përmirësuar baza ligjore ose duhet plotësuar baza ligjore, gjithashtu edhe aspektet e tjera të cilat kanë të bëjnë me koordinimin ndërinstitutional, sepse si një sektor shumë i rëndësishëm gjithashtu e dimë që është edhe me disa adresa, qoftë adresa në ministri, qoftë në Kuvend e shpeshherë kjo ka ndikuar edhe në një shpërputhje le të themi brenda entiteteve në kuadër të sektorit të ujërave.

Mirëpo, gjithashtu edhe problematikat, të cilat e përcjellin këtë sektor siç kanë të bëjnë me humbjet qofshin ato humbje komerciale, humbje teknike, nevojën për investime dhe reflektimin e tyre në kuadër të tarifave dhe përmbushjen e zotimeve karshi asaj se çka e ka reflektuar në tarifa dhe çka është realizuar faktikisht në investimet kapitale. Për këtë ne kemi qenë pro aktivë ku kemi bërë edhe një kërkesë drejtuar Zyrës Kombëtare të Auditimit që të na përcjellë informatat dhe hulumtimet e nevojshme me të dhënat e nevojshme mbi investimet kapitale për një periudhë të gjatë kohore dhe realizimin apo mos realizimin e tyre, dhe duke e përcjellur pra sektorin, duke qenë edhe në raportim në relacion me ARU-në gjithashtu edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe duke njohur bazën ligjore, problematikat, sfidat dhe potencialin e saj ka qenë me interes që të ulemi në një tryezë të përbashkët, në një takim të mbyllur për t'i diskutuar të gjitha haptazi, qartë edhe saktë në mënyrë që të adresohen qoftë në kuadër të kuadrit ligjor, qoftë në aspektin praktik dhe operativ të saj. Edhe një herë faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

DRITON HYSENI: Përshëndetje për të gjithë, jam Driton Hyseni anëtarë i Komisionit për Ekonomi. Prej fillimit të mandatit tonë të kësaj legjislature siç e tha kryetari dhe nënkryetarja kemi qenë shumë të fokusuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve të ujit në vend e

sidomos me synim që të kemi një performancë më të mirë të gjitha kompanive që merren me shërbimet e ujit në republikën tonë.

Pa dashtë me zgjatë për arsye se sot ju kemi ftuar juve që ju të na jepni informacionin në lidhje me performancën, në lidhje me gjendjen aktuale qoftë të nivelit të humbjeve që keni, qoftë në nivelin e matjeve të reja nga instalimi i ujëmatësve që janë në proces e sipër, besoj që janë bërë tanimë instalimet pothuajse në të gjitha KRU-të në lidhje me nevojën që ne të kemi një qartësi sa i takon ujit që prodhohet dhe ujit që distribuohet mandej në të gjitha rrjetet e ujësjellësve, e konsideroj shumë të nevojshme që ta themi se ky takim synon një bisedim shumë të sinqertë në mes neve si komision që monitorojmë sektorin edhe të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në sektorë me qëllimin e vetëm që nga ky takim të marrim informacione sa më të qarta, qoftë për nevojën e ndryshimeve legjislative që do të kemi përpara vetes në muajt në vijim, por edhe qoftë për hapa tjerë, të cilët mund të ndërmerren qoftë në ndarjet buxhetore që do bëhen, qoftë me bashkëpunimin që do të kemi me njësinë për monitorimin e ndërmarrjeve publike në këtë rast edhe me zëvendësministrin që e kemi prezent këtu, zotin Mjeku, me qëllimin e vetëm që ne si komision, ju si KRU, ministria, të gjithë akterët të ofrojmë një shërbim sa më të mirë për qytetarët sepse mendoj që ajo çka na bashkon të gjithëve është nevoja që qytetarët e vendit tonë t'i shërbejmë në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Konsideroj që kemi një takim jashtëzakonisht të qëlluar dhe me kënaqësi do t'i dëgjojmë të gjitha komentet, analizat e bëra nga ana juaj dhe normalisht edhe sfidat me të cilat ju po ballafaqoheni, të gjitha KRU-të një nga një me qëllim që edhe ne si komision ta japim le të themi atë kontributin tonë në eliminimin e sfidave që janë duke ju përcjellur për shumë vite, sidomos tek pjesa e investimeve kapitale, por edhe tek mundësia që ta kemi edhe një përfshirje edhe më të madhe të të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit që ofrohet nga KRU. Ju falënderoj kryetar, më vonë ndoshta me pyetje ndërkohë nëse shohim diçka të nevojshme.

KRYETARI: Fjala për juve deputete!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Përshëndetje kryetar,
Drejtoreshë,
Zëvendësministër,

Të gjithë ju përfaqësues të ARU-ve këtu, realisht ne si komision kemi pas fokus këtë sektor, por sa i përket raporteve, të cilat ne i kemi marrë në vazhdimësi nuk ka pas rritje të ndonjë performance, të ndonjë ARU veçmas dalluar apo krahasuar viteve të kaluara, por sa i përket bashkëpunimit mes neve dhe juve normalisht që duke e dëgjuar njëri-tjetrin dhe duke bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin, duke i pas parasysh sfidat e juve dhe ne si komision sa i përket ndarjeve buxhetore, legjislativit të cilit ne mundemi me i rregullua përmes legjislativit, pengesat që ju i keni sigurisht që gjatë debatit tani bashkërisht do të kalojmë edhe në pyetje direkte dhe konkrete, por për fillim faleminderit për pjesëmarrje.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e hapi debatin zëvendësministër apo... mirë në rregull është.

GETUAR MJEKU: Zëvendësministër i Ekonomisë: Faleminderit, kryetar për fjalën!
Në radhë të parë që na keni ftuar për këtë diskutim, mirë që jemi në diskutim të mbyllur pa media, jo pse nuk duam të jemi transparent por uji është çështje e ndjeshme dhe është mirë ta diskutojmë kështu hapur mes vete, e në radhë të tjera ndoshta ta njoftojmë edhe publikun.

Shkurt, po theksoj 2-3 pika meqë kemi shumë pjesëmarrës këtu dhe kjo është një sfidë shtesë e sektorit, domethënë janë shumë aktorë të domosdoshëm por që na ndërlikon pastaj komunikimin dhe bashkëpunimin që është i duhur për sektorin. Një lajm i mirë për ujin në përgjithësi është rritja e mjeteve që kemi në dispozicion për investime. Sivjet janë planifikuar diku rreth 6,3 milionë investime me të hyrat vetjake të ndërmarrjeve, po këtu shtohen edhe 5,5 milionë euro që jepen prej buxhetit të shtetit përmes Ministrisë së Ekonomisë. Janë rreth 6.3 caqet, me mjetet vetanake të ndërmarrjeve kjo mundet me ndryshua nëse ka ndryshim të planit të biznesit, pra është një shifër dinamike që caktohet prej vetë ndërmarrjeve, por besoj që kanë edhe detyrimin e raportimit në ARU, kurse prej Qeverisë tashmë veç janë kontraktuar 5.5 milionë euro, pak më shumë 5.6 janë që është një rritje 10 ose 11 fish prej mjeteve që i kemi pas në dispozicion për sektorin e ujërave në vitet paraprake. Ligji për ujërat është i qartë, thotë që investimet duhet të bëhen përmes Ministrisë së Ekonomisë ose përmes KRU-ve, në këtë rast ne kemi zgjedh që investimet me i krye vetë KRU-të meqë ato janë përgjegjëse edhe për menaxhimin e sistemit të ujësjellësit.

Një aspekt tjetër që duhet me cekë e që e ndërlikon punën në sektorin e ujërave është që ne si ministri flasim për mbarëvajtjen e ndërmarrjeve në aspektin e qeverisjes korporative, pra tërthorazi përmes këtyre ndërmarrjeve kemi edhe një përgjegjësi për ekonominë e ujërave ose për ujësjellësin në përgjithësi, si ministri kemi detyrim parësor hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre për sektorin e ujit. Kështu është i organizuar sektori u ujit në Republikën e Kosovës, kjo nuk është e me domosdo, por është një faktor që duhet me pas parasysh ne kur bashkëpunojmë. Operimi i ndërmarrjeve në përgjithësi ka qenë i kënaqshëm për vitin 2023, përkundër sfidave. Të gjitha ndërmarrjet janë me fitim operativ, disa kanë edhe fitim financiar edhe pas zhvleftësimit, një ankesë e kamotshme e ndërmarrjeve publike është norma e lartë e zhvleftësimit të aseteve, por është domethënëse që shifrat janë përgjithësisht pozitive, ndërmarrjet mbulojnë të gjitha shpenzimet e tyre operative dhe në masë po arrijnë edhe investime me mjete vetjake me bë.

KRU “Prishtina” tash ka një fitim edhe 2 milionë euro që është shifër mbresëlënëse, ndërsa po vazhdon me e shlyer kredinë që e ka për fabrikën e ujit, ndërkohë po përgatitë investime tjera, por edhe ndërmarrjet tjera kanë shifra pozitive. Për ujësjellësit ne nuk presim dividendë, por presim që këto ndërmarrje me qenë të qëndrueshme që me investua në rrjet më së pari me e

mirëmbajt rrjetin që kanë, por edhe me investua dhe me zgjerua shërbimin, ndoshta edhe në zonat ku ekonomikisht nuk ka përfitim, por uji është një shërbim i domosdoshëm për qytetarët, andaj ne do t'i shtyjme ndërmarrjet me vazhdua me investime, qoftë me mjetet që ndajmë si qeveri, prej buxhetit të shtetit, por qoftë edhe me mjete vetanake. Më mirë po e lëmë atëherë për pyetje-përgjigje diskutimin mëtejme. Faleminderit për fjalën!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendësministër! Urdhëro, drejtoreshë!

HAJRIJE MORINA: Hajrije Morina, drejtoreshë e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit. Përshëndetje, zoti kryetar, Përshëndetje të nderuar deputetë, Përshëndetje të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe përfaqësues të kompanive rajonale të ujësjellësit.

Së pari, më lejoni të ju falënderoj për organizimin e këtij takimi dhe uroj që ky takim të shfrytëzohet për një diskutim të hapur dhe të sqartë të të gjitha palëve të involvuara në sektorin e ujit dhe të përmbillet me një dakordim për një numër veprimesh konkrete për të mirën e sektorit dhe të mirën e përgjithshme. Nga këndvështrimi i Autoritetit Rregullator për shërbimet e ujit sektori i ujit nuk është duke performuar mirë. Janë disa çështje madhore, të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Ne i kemi identifikuar tri çështje, të cilat mendoj që janë të rëndësishme me u diskutua bashkërisht dhe të dakordohemi se si mundemi të punojmë më mirë në këto drejtime. Performanca e dobët e kompanive të ujësjellësit, ku do të veçoheshin humbjet e larta të ujit. Realizimi i investimeve kapitale të aprovuara me proces tarifar dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotur.

Dhe, çështje e tretë është koordinimi dhe komunikimi ndër-institucional për çështje të zhvillimit të sektorit. Sa i përket humbjeve të ujit përkundër asaj që vitin e fundit ka lëvizje të lehta pozitive, siç e përmendi edhe zëvendësministri sa i përket rritjes së faturimit dhe inkasimit për shërbimet e ujit, niveli i humbjeve të ujit është rrit prej 55% në 61%. Ky përkeqësim i ujit të faturuar ka ardh për arsye se të gjitha KRU-të nga prilli i vitit 2023 përveç KRU “Hidro Drini”, raportojnë për ujin e prodhuar sipas matjes, bazuar në vendimin e Rregullatorit të ujit të gjitha vendburimet të kenë ujëmatës të instaluar në pikat e shfrytëzimit të resursit të ujit dhe funksional. Përqindja e raportimit të humbjeve të ujit mund të mos jetë plotësisht e saktë ende për shkak që raportimi i saktë dhe me matje e ujit të prodhuar nuk ka filluar në fillim të vitit kalendarik të vitit 2023. Domethënë, ka tendencë të përkeqësimit edhe më tutje në vitin 2024.

Sa i përket realizimit të investimeve kapitale. Është çështje tjetër që realizimi i investimeve kapitale është në nivel shumë të ulët. Sektori ka nevojë sidomos për investime në infrastrukturë të ujit e cila është në gjendje shumë të keqe. Ka nevojë të bëhet një listë e prioritetëve që krahas zgjerimit të punohet edhe në rehabilitimin dhe zëvendësimin e infrastrukturës ujore. Investimet e

donatorëve dhe kreditë janë të fokusuar kryesisht momentalisht në impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura dhe KRU-të vazhdojnë të kenë vështirësi të mëdha në realizimin e investimeve kapitale që aprovohen në proces tarifor ku përqindja e realizimit të tyre në shumicën e kompanive të ujësjellësit nuk i kalon 30%.

Çështje tjetër për tu përmendur gjithashtu është koordinimi dhe komunikimi i rregullt ndërinstitucional, sektori ka nevojë për një koordinim dhe komunikim të rregullt ndërinstitucional. ARU mendon se një komunikim i rregullt dhe koordinim ndërinstitucional do të ishte në dobi të zhvillimit të mëtutjeshëm të sektorit. Komunikimi jo adekuat midis institucioneve për sa i përket çështjeve të definimit të kaheve zhvillimore të sektorit dhe përcaktimit të prioriteve për investime në infrastrukturë të ujit dhe ujërave të zeza, vlerësohet të jetë një prej problemeve madhore të sektorit. Investimet në infrastrukturë të ujit dhe ujërave të ndotura të cilat financohen nga komuna apo qeveria, shpesh nuk reflektojnë prioritetet e prezantuara në planit e biznesit të kompanive të ujësjellësit apo planet e menaxhimit të aseteve.

Problematikë është gjithashtu dhe shpërndarja e investimeve nëpër regjione, ne kemi pasur ndërmarrjet e ujësjellësit, institucionet e informuara që kemi pas një auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit pasi është pjesë e këtij takimi dhe rekomandimet kanë dalë që investimet, planet e biznesit duhet të reflektojnë, planet e menaxhimit të aseteve, planet e biznesit që dorëzohen në ministri duhet të jenë të njëjta me ato që dorëzohen në Rregullator të ujit dhe zbatimi i investimeve kapitale duhet të realizohet në masën qind për qind sidomos në ato që aprovohen në proces tarifor dhe të hyrat vetanake. Këto janë disa tri çështje që ARU i ka identifikuar si të rëndësishme për të diskutuar sot. Unë po besoj që edhe institucionet tjera e kanë fjalën e vetë për të paraqitur disa nga sfidat e sektorit dhe të shpresojmë që në formë të këtij takimi siç e përmendi edhe zoti kryetar të dalim me rekomandime konkrete për të mirën e zhvillimit të sektorit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, drejtoreshë!

Urdhëro, kush e donë fjalën? Urdhëro fjala për ju! E kam mbyll takimin pa media për me qenë pak më të lirë, pa ngarkesa sinqerisht nuk kemi asnjë, e mori ai pastaj ju.

URIM GASHI: Përshëndetje për të gjithë, unë jam Urim Gashi, kryesues i Bordit të KRU “Gjakova” sh. a.

Kompania KRU “Gjakova” ka pas një performancë të mirë të vitit 2023, ka pas një tejkallim të planit të biznesit. Përmendëm investimet vetanake, KRU “Gjakova” ka pas investime vetanake në vlerë 930 mijë e 496 euro, kurse në plan të biznesit për vitin 2023 kanë qenë 963 mijë euro, kështu që jemi afruar në shifër të afërt ose mos me thënë të arritshme. Duke e krahasuar me të hyrat që i kemi për vitin 2023 kanë qenë 4 milionë e 875 mijë e 866 euro. Kurse investimet në nivel 930 mijë euro afërsisht janë diku rreth 25% e të hyrave ose targetimit.

U diskutua për humbjet e ujit, humbjet e ujit në KRU “Gjakovë” për vitin 2023 janë 47.78%, kurse në plan të biznesit e kemi pas 46.39%. E konsideroj një projekt që e presim për investim në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë për ndërrimin e gypave të asbestit dhe ndërrimin e ujëmatësve, i cili jemi në faza goxha të mira. Besoj që nëse veç realizohet ose na përkrah Ministria e Ekonomisë në realizimin e projektit konsideroj që humbjet e ujit do të ulëshin në nivel shumë të kënaqshëm. Edhe kemi bë 2-3 ose pilot projekte, ku kemi ndërruar në zona të caktuara ujëmatësit dhe kemi pas humbje shumë të mëdha edhe kemi ardh në përfundim që prej nivelit të humbjeve rreth 30% që kanë qenë janë zbrit humbjet diku nën 30%. Krejt kjo ka qenë veç efekti i ndërrimit të ujëmatësve. Pastaj si sfidë të KRU “Gjakova” konsideroj që janë çmimet goxha të larta të klorit, alumin sulfatit dhe të karbonit aktiv.

Po ashtu janë çmimet e larta të energjisë dhe rritja e çmimeve të derivateve. Kurse shfrytëzohet rastin meqenëse janë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, si kërkesë e jona e kompanisë kishte me qenë që neve menaxhojmë me Liqenin e Radoniqit është si sfidë lejimi i peshkimit, ose me thënë të Shoqatës së Peshkatarëve që neve po na sjellë kompozitet në mes të banorëve të zonës dhe Shoqatës së Peshkatarëve. Pastaj, janë tarifatat e ulëta të ARU-së që konsideroj që është mirë të ngrihen duke pa ngritjet e çmimeve të ndryshme në treg edhe është një sfidë tjetër, ose një kërkesë me thënë prej Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës na ka ardhur kërkesa për hartimin e elaboratit për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare për burimet e ujit.

Unë mendoj që është dashtë me u konsiderua ose me u shqyrtua prej Ministrisë së Mjedisit në mënyrë që të gjitha kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe që posedojnë ose menaxhojnë me liqene që zonat e mbrojtura mu hartua elaborati nga Ministria e Mjedisit, për të gjitha kompanitë që posedojnë liqene ose menaxhojnë me liqene siç e kemi neve Liqenin e Radoniqit. Kaq kisha, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala për juve, veç afroni mikrofonët pak se salla është e madhe e ka probleme.

ARSIM FETAHU: Përshëndetje për të gjithë, jam Arsim Fetahu kryeshefi ekzekutiv i KRU “Prishtinës”.

Kisha filluar me pika shkurtimisht për performansën e kompanisë KRU “Prishtina” gjatë vitit 2023, është e vërtetë se të gjitha kompanitë e ujit pak a shumë i kanë sfidat e njëjta, mirëpo mund të them që në KRU “Prishtina” në vitin 2023 ka qenë një vit shumë i mirë edhe përkundër disa sfidave që do t’i përmendi pak më vonë. Kisha filluar fillimisht me auditimin nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku nga opinioni kundër për shumë vite kemi arrit të marrim një opinion të kualifikuar dhe jemi duke punuar vazhdimisht që ndoshta edhe këtë vit ta marrim edhe

opinionin e pa kualifikuar që është opinionimi më i lartë, shpresojmë të arrijmë se është sukses i gjithë sektorit.

Sa i përket sukses jashtëzakonisht të lartë ka pas shkalla e inkasimit që ju mund ta dini në të kaluarën shkalla e inkasimit ka qenë nën shkallën 90%, kurse gjatë vitit 2023 shkalla e inkasimit në raport me planifikimin ka qenë 105% kurse në raport me vetë faturimin ka qenë 103% që nënkupton që më shumë është inkasuar se vetë që është faturuar gjatë vitit 2023. Fitimi operativ përkundër ka qenë jashtëzakonisht i lartë përkundër pagesës së kredisë për Bankën Gjermane ... për fabrikën në Shkabaj, e cila këtë vit në vitin 2024 me pagesën e këstit të parë përfundon atëherë prapëseprapë edhe përkundër pagesës për vite është mbi 2 milionë dhe jemi jashtëzakonisht të lumtur për këtë performancë. Investimet kapitale për vetë fondin e kompanisë janë diku përafërsisht pak më pak se 1 milionë ose rreth 60% të realizuara gjatë këtij viti, mirëpo mund të ceket këtu edhe përkrahja që ka filluar vitin e kaluar prej Ministrisë së Ekonomisë që është shumëfishuar këtë vit edhe për fat të mirë që qysh tash kemi filluar pjesën e prokurimit e cila nganjëherë dinë edhe t'i ketë vonesat e veta, mirëpo për korrektësi sivjet kemi filluar shumë më herët dhe besoj që të gjitha fondet që janë ndarë prej ministrisë të realizohen.

Kjo ka pas progres mund të them të madh edhe në pjesën e shkyçjeve edhe pjesë tjera të cilën unë nuk isha lëshuar, isha ndal pak edhe te sfidat. Sfidë mbetet humbja e ujit, momentalisht në vitin 2023 kemi mbyllur shkallën 56,7% që është e njëjtë me vitin e kaluar, ndërsa problematikë për neve dhe për gjithë sektorin mbeten rastet sociale të cilat nuk subvencionohen edhe kishte me qenë mirë të bëhet një zgjidhje në kuadrin praktik legjislativ për këtë, gjithashtu edhe pjesa e objekteve fetare, të cilat vetëm lexohen por nuk faturohen, gjithashtu edhe pjesa e zjarfikësve edhe gjërave tjera. Definitivisht një nga dobësitë është edhe infrastruktura shumë e vjetërsuar të cilën jemi duke munduar që bashkërisht qoftë me fondet tona, qoftë me ministri, qoftë me donacione që për fat të mirë KRU “Prishtina” i ka, jemi jashtëzakonisht në rrugë të mirë që këto infrastrukturën ta përmirësojmë. Vlen të ceket se në pjesën e ... ujit, por edhe në pjesën e llogaritjes kalkulimit të tarifave ne kemi kontraktuar një konsulentë gjermane e cila ka për ta përkrahur dhe ARRU-në, por gjithashtu ka me na përkrahë edhe neve për zvogëlimin e uljeve të ujit dhe është kontratë 5 vjeçare dhe besoj që objektiv i kësaj është që brenda tri viteve të zvogëlohen humbjet për 10% gjë që neve na mundësohet të kemi donacion për një objekt administrativ në vlerë mbi 1 milionë që do të jetë si grand kushtimisht nëse arrihet kjo performancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, i nderuar!

(Ndërprerje e incizimit)

SIMON BALAJ:Hidro Drin dhe është deshtë që të merremi me disa çështje që kanë qenë në aspektin e organizmit të ndërmarrjes duke e implementuar organogramin i cili është uniform

tash në ndërmarrje. Kemi arrit që të gjitha rregulloret përkatëse të cilat janë relevante për ndërmarrje publike në këtë rast KRU “Hidro Drini” t’i azhurojmë dhe t’i bëjmë sipas rregulloreve që janë në përgjithësi në fuqi.

Jemi të parët që kemi aprovuar dhe kemi marrë Rregulloren për matje të ujit me ujëmatëse. Ju kisha lut që mos me u keqkuptua zonja Morina për shkak që pjesërisht ajo deklarata e juaj nuk ishte tërësisht e saktë, pasi që ne e bëjmë matjen e ujit që nga tetori i vitit të kaluar e bëjmë matjen e saktë të ujit në Hidro Drin, prandaj janë që thashë gati 7 muaj që e bëjmë këtë matje të ujit të saktë, për shkak që më parë nuk ka pas ujëmatës të instaluar, ujëmatës kryesor. Ne kemi edhe në sistemin e ARRU-së, por edhe në koordinim me menaxhmentin ... kemi arrit që t’i vendosim ujëmatësit në fund të tetorit të gjithë ujëmatësit dhe bëjnë matjen e saktë të ujit. Ajo na ka ndihmuar që kemi gjendje reale të problemit të ujit, që tashmë e kemi prodhimin e ujit që realisht i prodhon 4,1 trilion metra kub në muaj.

Shpenzimet, ose humbjet, janë të mëdha, sepse ne e kemi bërë një prerje. Janë paraqitur humbjet e mëparshme dhe tani, ka një diskrepancë, por humbjet janë realisht të mëdha. Por, kemi arritur që edhe ato t’i konsolidojmë, të kemi... jemi në procesin e duhur, i cili na jep besimin se do të kemi mundësi që brenda një afati kohor, duke e ndryshuar pak metodologjinë e matjeve të ujit dhe prodhimit, që i bie se ne kemi tendencë që ta bëjmë ta zhvillojmë modulën hidraulik, që realisht ta zvogëlojmë prodhimin e ujit dhe ta përcaktojmë sipas mundësive që ta furnizojmë qytetarin, apo klientin, me ato sasi që janë të nevojshme dhe të domosdoshme.

Në atë drejtim, i kemi arritur që t’i përcaktojmë zonat e matjeve të ujit, të ashtuquajtura DME zonat, të cilat edhe e kemi një sistem të dhënave i cili është në nivel të duhur dhe shpresojmë që me aplikimin e metodave të sakta të matjeve kemi me e arrit atë qëllim.

Për sa i përket zhvillimit të kompanisë në aspektin e... jemi kompani që është duke operuar me bilanc pozitiv dhe kemi investimet kapitale deri më tani kemi arritur që të gjitha gati pothuajse 95% t’i kryejmë. Sfidë është se ne i kemi shumicën e objekteve që i kemi, nuk i kemi në pronësi. Duhet ta theksojmë atë që na duhet ndihma përkatëse prej ministrive, apo prej komunave, që të na ndihmojnë që ato objekte t’i kemi ne në pronësi. Vetëm i kemi në menaxhim një pjesë të madhe të tyre.

Sfidat tjera, për shkak të specifikave që janë në Hidro-Drin, po edhe në të gjitha ndërmarrjet, është edhe janë trajnimet, ose trajnimet e duhura, ose zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, për të kryer ato detyra që përcaktohen. Sepse, ndoshta edhe planet që i bëjnë janë ambicioze, edhe legjislacioni që është në fuqi është ambicioz, edhe të gjitha ato standarde, ose normativa, janë sipas meje ambicioze, por për të arritur deri te ajo neve na duhet të kemi edhe stafin, i cili është në gjendje në mënyrë aktive t’i arrijë ato qëllime.

Unë, përveç kësaj, siç e ceku edhe folësi më parë, zoti Fetahu, janë edhe këto rastet sociale, ne në Hidro-Drin i kemi objektet fetare, të cilat kemi shpenzime të mëdha. Ju e dini, është manastiret e ato kishat dhe ato gjërat që janë, ato ne duhet të kemi një bashkëpunim, ose një platformë, metodologji, të cilën veç duhet realisht ta zhvillojmë dhe të përcaktojmë, se ato janë humbje edhe teknike, në kuptimin administrativ, dhe na rriten të gjitha borxhet.

Përveç kësaj, do ta kisha cekur edhe një... e kam edhe një sugjerim, ose rekomandim. Të gjitha pellgjet që ne i kemi në Kosovë tan i janë në atë aspektin e përcaktimit quhen “nonsensitive” cases, që i bie jo të ndjeshme ndaj largimit të ujërave të ndotura. Dhe, në këtë rast ne në Pejë e kemi hetuar, ose kemi inspektuar, kemi kontrolluar, disa ndotës që e kanë larguar ujin dhe e kanë vendosur “ujë i ndotur” disa prodhues ushqimor dhe e kemi parë se kapaciteti i përpunimit të ujit në këtë fabrikë me ato përbërës është rritur. Do të thotë, janë rritur shpenzimet operative, që neve na ndikon edhe në koston e operimit.

E shoh të arsyeshme që kjo tanimë që është problem për largimin e ujërave të ndotura, të shihet si gjendje që duhet të përmirësohet. Secili marrës duhet të kalojë në kushte sensitive, domethënë që i bie se ne duhet t’i përafrojmë të gjitha legjislacionet standardet me Bashkësinë, ose me direktivat që janë në fuqi të Bashkësisë Evropiane. Kjo duhet të bëhet deri në 2035-tën, që i bie për një dekadë.

Prandaj, ju lus, sepse këto ndikojnë tek objektet që ndërtohen tani e tutje dhe që janë ndërtuar deri më tani, që s’kanë pasur, s’e kanë zhvilluar këtë koncept. Dhe, në të ardhmen duhet secili, si shtet që jemi, duhet të ballafaqohemi me atë problem dhe kjo sfidë duhet të adresohet sa më shpejt që është e mundur, që 2035-ta nëse nuk e plotësojmë këtë kusht, do të jemi jashtë kornizave dhe nuk do të jemi në gjendje të aplikojmë për asnjë investim, apo nuk do të jemi në gjendje të aplikojmë e as të pranohemi, as si shtet që në të ardhmen ka tendencë që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.

Kjo ka të bëjë shumë është me rëndësi, që edhe prodhuesit e ndryshëm që ndikojnë në mjedis, siç janë objektet, ose fabrikat, ose prodhimi, ata duhet kur të jepet leja mjedisore, duhet ta plotësojnë kushtin themelor, i cili gjatë largimit të ujërave të ndotura duhet t’i plotësojë ato kushtet të cilat janë në fuqi tani, po edhe në të ardhmen, me atë koncept, që realisht kjo nuk ndodhë. Shumica e prodhuesve që e bëjnë largojnë ujin i cili nuk kontrollohet. Ne në Pejë e kemi hetuar atë prodhues dhe kemi shkuar, e kemi gjobitur, do të thotë e kemi gjobitur sipas ligjeve që janë në fuqi, i cili ato gjoba janë të vogla, realisht janë shumë të vogla dhe nuk ka... Impjantet për trajtime që secili duhet ta ketë, nuk e aktivizojnë në shumicën e rasteve.

Prandaj, apeloj që këtë mangësi, këtë sfidë që ta njohim më shumë mjedisin, edhe në këtë rast mendoj që duhet të Qeveria, secila qeveri, ta ketë kujdesin që si sfidë është që njohësit e mjedisit dhe ekspertët mjedisor ta njohin më mirë legjislacionin në fuqi, të njohin kushtet mjedisore që

janë dhe që duhet të bëhen edhe të bëhet njëfarë lloj decentralizimi i inspektimit nëpër komunat përkatëse, ose regjionet përkatëse, sepse e shoh që janë centralizuar shumë dhe derisa vjen një inspektor në një regjion tjetër për ta inspektuar gjendjen çfarë është për ndotje të ujit, atëherë është edhe vonë edhe nuk... Kërkoj falje, ndoshta pak e zgjata.

KRYETARI: Zoti Lajçi!

AFRIM LAJÇI: Përshëndetje!

Jam Afrim Lajçi, këshilltar në Këshillin Ndërmintor për Ujëra.

Fillimisht desha të bëj një koment për parafolësin. Do të thotë, u tha që legjislacioni ynë duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE-së, sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura. Në fakt, legjislacioni anë është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-së në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura.

Problemi qëndron në zbatimin e këtij legjislacioni, domethënë ende ka kompani private, po edhe të gjitha kompanitë tona publike që shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në recipientë.

Do të thotë, ky ishte veç një sqarim lidhur me këtë çështje. Në ndërkohë, desha t'i jap disa komente të mija lidhur me temën që po e diskutojmë, meqenëse tema boshte e kësaj tryeze është zbatimi i legjislacionit në fushën e shërbimeve të ujit. Unë konsideroj që është mirë me i ngritë edhe me i diskutua dhe mundësisht ndoshta me i rekomandua rekomandimet specifike për krejt çështjen.

Një është integrimi i sistemeve rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit në kompanitë rajonale të ujit. Ne aktualisht në nivel të vendit i kemi rreth 300 sisteme rurale, të cilat nuk menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujit. Një pjesë e madhe e këtyre sistemeve janë në zonën, në rajonin e Prizrenit, në ato fshatra që janë të banuara me minoritet boshnjak kryesisht.

Edhe fakti, që këto sisteme nuk menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujit nënkupton që këto praktikisht nuk menaxhohen fare nga askush, meqenëse komuniteti përkuqdeset për to. Por, problematik është fakti që nuk ka monitorim të cilësisë së ujit të pijshëm, domethënë rreziku potencial i helmimit apo problemeve shëndetësore të popullatës është gjithmonë i pranishëm. Përveç kësaj nuk ka licencë të shërbimit, që është problem i rregullativës ujore. Gjithashtu, nuk ka leje të nxjerrjes së ujit për këto sisteme. D.m.th. janë një sërë problemesh ligjore, nëse po flasim për problemet ligjore të cilat janë të ndërlidhura me mosintegrimin e këtyre sistemeve rurale në kompanitë rajonale të ujit.

Edhe problemi kyç është që qëndrueshmëria e këtyre sistemeve është shumë problematike, meqenëse nuk ka mirëmbajtje të mirëfilltë. Mendoj që KRU-të bashkë me autoritetin rregullator

të hartojnë një plan të integritit të këtyre sistemeve bashkë me ndihmën e komunave dhe Qeverisë.

Çështje e dytë ka të bëjë me rastet sociale. Edhe kjo është një kategori ligjore. Me ligj është paraparë që është obligim i Qeverisë për të mbuluar shpenzimet e familjeve në nevojë. Kjo deri tash nuk ka ndodhur në asnjë Qeveri. Ne disa herë kemi tentuar nxjerrjen e vendimeve për mbulimin e shpenzimeve të rasteve sociale, kjo ende nuk po zbatohet. Mendoj që është me rëndësi edhe për qëndrueshmërinë e kompanive rajonale të ujit.

Çështja e tretë është investimet në sistemet e ujësjellësit që bëhen nga komunat. Me ligj, përcaktohet qartë që investimet bëhen nga kompanitë rajonale të ujit ose nga ministria përgjegjëse, Ministria e Ekonomisë. Në praktikë, kemi shumë raste që komunat ndërmarrim investime në ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit e që është problematik, sepse shumë herë këto investime nuk bëhen me ndonjë prioritetizim të duhur, cilësia e këtyre investimeve është shumë problematike.

Mendoj që është mirë të respektohet dispozita ligjore e cila përcakton që investimet në sistemet ujësjellëse të bëhen ekskluzivisht nga kompanitë rajonale.

Te humbjet e ujit është një problem i cili zgjat prej pasluftës, d.m.th. është një sfidë. Ndonjëherë mendoj se po ekzagjerohet si e tillë. Mirë është të përqendrohet në të, mirëpo humbjet e ujit nuk janë problem vetëm i Kosovës, po i të gjitha vendeve të rajonit. Bile, Kosova qëndron më mirë se vendet e rajonit. P.sh. Shkupi i ka mbi shtatëdhjetë për qind humbjet e ujit. Shqipëria i ka deri tetëdhjetë për qind. Mali i Zi po ashtu në ato përmasa. Pra, është problem që ndërlidhet me shumë faktorë, sundimin e ligjit, llogaridhënien, kapacitetet profesionale të kompanive etj.

Si zgjidhje për këtë çështje, ne kemi propozuar të krijohet mekanizmi sipas të ligjit këshilli ndërministror, Qeveria i mban përmes Ministrisë llogaridhënës menaxhmentin e kompanive siç përcaktohet me Ligjin për ndërmarrjet publike për caqet e performansës.

Sa i përket investimeve kapitale që i përmendi drejtoresha, pajtohem që janë të vogla, mirëpo këtë çështje duhet rishikuar edhe në kontekstin a po planifikohen në mënyrën e duhur këto investime kapitale dhe në kontekstin e tarifave që aktualisht janë të ulëta për të siguruar investime substanciale, meqenëse po themi se shkalla e arkëtimit në nivel të sektorit më duket se është afër qind për qindëshit. Nëse arkëtohen qind për qind të faturimeve, atëherë kapaciteti investiv pothuajse është shterur. Duhet ndërlidhur këtë çështje edhe me rritjen e tarifave.

KRYETARI: Faleminderit z. Lajçi!

Do të ishte mirë së paku bashkërisht që për këto problematika të kemi rekomandime se si dilet nga to, a ka zgjidhje. Është me rëndësi që ne të shohim opsionet e alternativat. Ne i kemi

përfaqësuesit e Qeverisë, të kompanive e deputetët. A do të ndryshojmë ligjin, a do të ndryshojmë hapat operacionalë, a do të ndryshojmë ndonjë tip organogrami, a do të ndryshojmë ndonjë tip përgjegjësie? Diçka duhet të bëjmë ne për ta ndryshuar këtë gjendje çfarë jemi.

FADIL BERISHA: Faleminderit për ftesën!

Të nderuar kolegë,

Unë e falënderoj z. Lajçi që potencoi një prej sfidave kryesore.

Unë jam Fadil Berisha, u.d. i kryeshefit ekzekutiv në kompaninë rajonale të ujësjellësit Hidroregjioni Jugor në Prizren.

Natyrisht, një prej misionëve tona kryesore është furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm kualitativ. Në këtë synim, një prej problemeve që jemi ballafaquar është edhe humbja e madhe e ujit të pijes. Ky është problem, z. Lajçi. Në Prizren, është problem, sepse humbja e madhe e ujit, në bazë të statistikave del se kemi pasur zona të caktuar me furnizim jo të qëndrueshëm dhe jemi duke punuar në atë drejtim që ta kemi një furnizim qind për qind.

Një prej sfidave kryesore, ne i kemi katër njësi operative, Prizrenin, Suharekën, Malishevën dhe Dragashit. Ne kemi në Dragash 88,9 për qind të fshatrave që nuk janë nën menaxhimin tonë, edhe pse ligjërisht do të duhej të ishin. Ne i kemi të regjistruar vetëm 1650 konsumatorë. Nga ata të cilët mbi pesëdhjetë për qind nuk janë konsumatorë të rregullte dhe nuk mund të operojmë si njësi nga aspekti financiar me kaq numër të vogël të konsumatorëve. Pra në Dragash ne i kemi në menaxhim vetëm 11,1 për qind. Në Malishevë kemi 54,8 për qind të fshatrave që fare nuk i kemi në menaxhim, në Suharekë 50 për qind, ndërsa në Prizren 52,6 për qind. Këtu hyjnë edhe fshatrat mbi Prizren, edhe ato të minoriteteve.

Në këtë drejtim, ne kemi kërkuar vazhdimisht mbështetjen nga Autoriteti i Ujërave. Kemi pasur takime të shumta dhe kemi kërkuar mbështetje edhe nga ministria përkatëse, edhe nga njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike. Dua ta potencoj edhe një herë zyrtarisht, kjo praktikë njëherë e përgjithmonë nuk duhet të tolerohet. Duhet të zbatohet ligji. Nëse ne duhet ta zbatojmë ligjin, atëherë duhet t'i detyrojmë këto fshatra që të futen nën menaxhimin e kompanisë së licencuar.

Në këtë drejtim, është edhe çështja e kualitetit të ujit. Kjo është sepse nuk i kemi nën kontroll. Nuk është puna vetëm e misionit, por kualiteti i ujit të pijes është prioritet mbi prioritetet. Unë them nëse nuk është uji kualitativ, atëherë më mirë të mos ketë fare furnizim, sesa të jetë i helmuar.

Një prej sfidave, është ai në Prizren, jo që nuk ka pasur investime. Ka pasur shumë investime nga donatorë, komuna e Qeveria, por ka shumë investime milionëshe të cilat ose nuk kanë qenë mirë të planifikuara, ose nuk kanë qenë mirë të realizuara dhe ne tani ballafaqohemi me problemet e

atyre projekteve të realizuara. Unë apeloj që të gjitha investimet kapitale duhet të jenë në bashkëpunimin e plotë me kompanitë e ujësjellësit, jo vetëm gjatë planifikimit, por edhe gjatë realizimit, edhe pse nga aspekti ligjor, Kuvendi Komunal thotë që nuk janë të obliguar, se e kanë organin e mbikëqyrës e forma të tjera. Unë mendoj se duhet të ndryshohet aspekti ligjor në këtë drejtim, edhe pse s'jam jurist. Edhe pse është investitor Kuvendi Komunal, obligativisht të detyrohet që në organin mbikëqyrës të jetë nga dita e parë edhe kompania rajonale e ujësjellësit.

Po e përmend një shembull. Ne e kemi një investim mbi 2.5 milionë euro në fshatin Zhur dhe kam konstatuar që kompania nuk ka qenë e implikuar në organin mbikëqyrës.

Harmonizimi i investimeve të planifikuara nga kuvendet komunale dhe me kompanitë, mendoj që duhet të jetë shumë më i mirë. Kam propozuar edhe më herë në Autoritetin e Ujërave që të ndryshohen afatet edhe me Ligjin për ndërmarrjet publike, pra afati i dorëzimit të planit të biznesit nga 31 tetor në fund të vitit.

KRYETARI: Urdhëro, e nderuar!

BURBUQE NUSHI: Faleminderit kryetar!

Unë jam Burbuqe Nushi prej Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, udhëheqëse apo koordinatorë ... për monitorimin e cilësisë së ujit të pijes.

T'ju them të drejtën, kur e kam marrë ftesën për sot, nuk e kam pasur idenë çka do të diskutohet. Vetëm diskutim rreth sfidave të ujit, të cilat janë të shumta. Nëse fokusohemi vetëm në ujin e pijshëm, atëherë unë nuk e kam diçka të qartë. I dëgjova krejt përfaqësuesit e kompanive, asnjëri nuk e përmendi cilësinë e ujit. Asnjëri prej tyre. Asnjë raport, asnjë shifër, asnjëri nuk e dhatë. Sa është cilësia e ujit? Për çka ekziston...? Çka ka mision kompania?

E dyta, në anën tjetër, u diskutuan humbjet. Unë e di që është paraja në pyetje. krejt në rregull, po për çka e keni mision atë kompani. Për çka i keni bordet? Për çka jeni kryeshefa ju, për këtë milet që e kemi këtu.

E dyta, Hajria e përmendi, drejtoresha e ARU-së. Ne në sektor jemi shumë të afërt. Ne funksionojmë fenomenal. Në përgjithësi. Pse ndodhi kjo? Hajria tha nuk po performon kompania. Afrimi e elaboroi si ndryshe. Nuk po mund ta kuptoj. Nëse humbjet nuk janë problem, nuk është ndonjë problem që nuk zgjidhet dhe duke u nisur prej faktit, kemi startuar me furnizim me ujë në vitet 1999-2000 e kemi pasur vetëm dyzet për qind qasje në sistemet qendrore të furnizimit. Sot i kemi më shumë se nëntëdhjetë.

Sipas raporteve të ARU-së, kemi startuar me cilësi më shumë se gjashtëdhjetë për qind kontaminim atëkohë. Sot kemi arritur diku 99, që sipas Direktivës Evropiane të Ujit, kur e arrin 99, e ke qind për qind.

Edhe një gjë mos të harroj ta them, në aspektin legjislativ, ne e kemi bërë transpozimin e direktivës dhe atë dy herë është amendamentuar ai udhëzim administrativ, i cili duhet të zbatohet prej kompanive. Unë për disa anëtarë të tjerë të bordit që nuk më njohin, këta të tjerët që më njohin, e dinë, para se të zbatohet ligjit, duhet të zbatohet. Duhet të lexohet dhe të shihet çka ka në ligj, kryesisht kryeshefat dhe anëtarët e Bordit. Asnjë prej anëtarëve të bordit nuk di çka është udhëzimi administrativ për monitorimin e cilësisë së ujit.

Kështu që, në përgjithësi, sektori si sektor, zoti kryetar, nuk është se është kushedi sa keq, kurrë më mirë s'kemi qenë. Kjo nuk d.t.th. që të jemi të kënaqur me atë që jemi duke bërë, po investimi qeveritar, po orientimi i investimeve duhet të jetë më i organizuar. Krejt këta që i dinë këto rregullore, unë do të vazhdoj si Institut të monitojë cilësinë e ujit.

KRYETARI: Faleminderit!

Është shumë e rëndësishme që ne e kemi përmendur si sfidë çështjen e cilësisë së ujit. Ne nuk po duam të hyjmë tash çështjen e laboratorëve e akreditimit të tyre. Por, po shkojmë radhazi po i dëgjojmë. E kemi edhe pjesën tjetër të pyetje-përgjigjeve, por konsideroj se jemi duke hyrë në temë tash.

Deputete, a pate pyetje?

Urdhëro....!

Në kohë, ju kërkoj mirëkuptim, që të jemi efikas.

HAJRIE MORINA: Shumë shkurt!

Vetëm një përgjigje ndaj komentit të z. Lajçi, fillimisht, që çështja e humbjeve të ujit nuk është problematikë aq e madhe sa po paraqitet, sepse në shtetet e regjionit humbjet janë edhe më të mëdha sesa ne. Kemi edhe shtete të regjionit që janë humbjet e vogla, sido që të jetë, Kosova i ka specifikat e veta. Kemi resurse të mangëta të ujit, edhe për neve është shumë e rëndësishme që të punojmë drejt uljes së ujit të pafaturuar. Për Autoritetin Rregullator është e rëndësishme ulja e ujit të pafaturuar.

Sa i përket çështjeve të tjera që u ngritën, prioritizimit të investimeve, koordinimit të investimeve, integritit të sistemeve rurale të ujësjellësit, të gjitha këto çështje i paraqita edhe vetë si kërkesë, ose nevojë dhe sfidë, për t'u koordinuar dhe komunikuar rregullisht si institucione. Kjo është shumë e dobishme dhe e nevojshme. Të gjitha këto çështje mund të

diskutohen, të sqarohen dhe t'u jepet një përgjigje. Ne si institucione duhet të ulemi dhe t'i diskutojmë si po i zgjidhim këto probleme. Sektori i ujit nuk mund të zhvillohet vetëm prej një institucioni veç e veç. Duhet bashkëpunim. Ndryshe nuk ka përmirësim.

KRYETARI: Urdhëro!

BATON BEGOLLI: Po, unë vetëm e kisha thënë këtë të fundit, edhe pse s'desha të merrem me asnjërin, t'ju them të drejtën. Kur kërkohet bashkëpunimi, atëherë ka qenë e udhës Hajrije një herë në tri vjet të na thërrisni, po kjo e kaluar është.

Sido që të jetë, ky sektor është për t'u krenuar me të, ta dini. Ju pëlqej apo jo, keni nise apo jo në të, unë po flas prej memories institucionale. Ka tentativa nga njerëzit të flasin për momentin që ata ia nisin. Është legjitime prej momentit që ata ia nisin, ta zhvlerësojnë atë që është bërë më herët, që të thuhet unë po bëj më mirë.

Ky sektor e ka një jetë. Kjo memorie institucionale na tregon që ne e kemi nisur qasjen në ujësjellës me pesëdhjetë për qind, sot e kemi mbi nëntëdhjetë për qind, apo shtatëdhjetë për qind të menaxhuar nga ujësjellësi.

Përgjegjësia është kolektive që të mund të futen ata ujësjellës rebelë nëpër fshatra të hyjnë nën menaxhim. S'ka një katund t'i thotë katundit tjetër s'ta ndaj ujin, se Ligji i ujërave thotë pronar i ujërave është shteti. Ligji i ndërmarrjeve publike thotë pronë e aseteve është shteti.

Nuk mund një komunitet a komunë të votojë për një komunë tjetër të mos ndajë ujin siç ka ndodhur me rastin e Istogut e Klinës. Këto sende duhet ndryshuar. Këtë gjë nuk kanë kapacitet ta bëjnë këta ujësjellës, e as ne si këshilltarë, sado që mund ta themi të njëjtën gjë.

A është ky sektor i mirë? është. Kush e thotë këtë? hiç mos u merrni me fjalët tona, se ne jemi subjektivë. Natyrisht se do të themi mirë për punën tonë. Po e thonë raportet ndërkombëtare. Kam shkuar në korrik, i ftuar nga Forumi Botëror i Ujërave dhe OECD-ja anëtarë të të cilit jemi, për të prezantuar modelin e Kosovës në nivel botëror. Shteti joanëtar t'u prezantojë shteteve anëtare modelin e Kosovës. Kemi shkuar dhe keni qenë shumë prej jush në Programin e Danubit, ku vit për vit veçohet Kosova në një aspekt më mirë sesa shtetet e tjera. Kam qenë nga Shoqata Botërore e Ujërave në Jordan për të prezantuar modelin e Kosovës për Lindjen e Mesme. Programi, takimet e përbashkëta të Ballkanit vit për vit që mbahen herë në Tiranë e herë në Prishtinë, e potencojnë që Kosova është dukshëm më mirë.

Pra, ka hapësirë për përmirësim. Ne si këshilltarë ndërministrorë që jemi në përfundim të mandatit në fund të këtij muaji, do t'ju thërrasim të gjithëve për t'ju prezantuar se çka është bërë në sektorin e ujërave dhe çka ne mendojmë se duhet të bëhet.

Nuk është mbajtur ai takim, që u tha askush s'mund të na ndalojë, një raport do t'ju vijë të gjithë hisedarëve të sektorit të ujërave.

Po flitet për rrjet të vjetruar. Ky mobil dhjetë vjet po i bën. Unë nuk e di që ujësjellësit kanë afat skadimi më pak se dyzet a pesëdhjetë vite. Ne e kemi nisur me pesëdhjetë për qind. D.t.th. krejt këto çka i kemi futur, janë të reja. E para.

Dy, në ato pesëdhjetë që i kemi pasur, kemi investuar dhe kemi rehabilituar më shumë se gjysmën e saj. Flitet për Kosovë që gypat e asbestit janë rrezik. Aty janë problemet te ne, në kuptim të humbjeve. Ama, jo rrezik të kancerit. Duhet të dihet se s'ka lidhje me kancer ajo punë.

Ne duhet të bëjmë shumë sende. Duhet parë si të bëhet konsolidimi në veri, pastaj në Shtërpcë. Ne kur e kemi nisur me tridhjetë komuna, dhe kemi ardhur në shtatë. Tash, krejt rajoni është duke ndjekur atë rrugë. Qysh të konsiderohet të bëhet diçka më tepër. Si të përmirësohet qeverisja korporatave? Ka tendenca të përmirësimit. Ne nuk jemi të politikës, shtatë Qeveri i këshillojmë. Besnikëria jonë ka qenë ndaj sektorit të ujërave dhe jemi besnik deri në fund.

Ka tendenca të përmirësimit. U përmendën edhe nga të tjerët. Por ka hapësirë për përmirësim. Nuk ka fajtor në këtë temë.

Po shoh se deputeti po do të reagoj.

KRYETARI: Po, lirisht!

DRITON HYSENI: Pa dashur t'ju pengoj, veç të kuptohemi drejt.

Po ndërlihem me zyrtaren e Institutit, znj. Burbuqe Latifi, në njërën nga mbledhjet e fundit të cilën e kemi mbajtur si komision, pikërisht ka qenë çështja e kualitetit të ujit e cila na ka përplasur shumë edhe neve si deputetë, për arsye se kishim një qëndrim nga njëri prej anëtarët që kemi problem me cilësinë e ujit në një shkallë jashtëzakonisht alarmante. Unë nuk u pajtova them të drejtën, për arsye se kemi qenë edhe si komision, sidomos në KRU Gjakova, po edhe në disa prej kompanive të tjera, dhe i kemi pyetur saktësisht se si bëhet matja e cilësisë së ujit. Si bëhet mostrimi, sa shpesh bëhen këto, sa janë funksionalë laboratorët nëpër KRU? Unë mendoj e pajtohem me atë që the që ta trajtojmë këtë aspektin e cilësisë së ujit.

Besoj që edhe përfaqësueset e KRU-ve e kanë menduar ndoshta si një hyrje mandej në pyetje, jo ta parashtrijmë këtë pyetjen e cilësisë së ujit, për arsye se do të ishte e pamundshme që ne të mos diskutonim sot cilësinë e ujit.

Dëshiroj që kompanitë të na tregojnë kapacitetet e veta për analizat brenda institucionit ku ata operojnë. Nëse nuk e kanë mundësinë të bëjnë testimet brenda institucionit, sa shpesh i bëjnë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Edhe një çështje tjetër doktoreshë kisha pasur dëshirë ta dimë nga ana juaj. Ne diskutuam për disa zona të cilat nuk janë të integruara në ujësjellës. A ka ndonjëherë monitorim nga Instituti të këtyre zonave. A shkohet ndonjëherë të merren mostra, me qëllim që shëndeti i atyre njerëzve, edhe pse nuk janë ato sasi të ujit që konsumohen nga ata qytetarë, s'janë të integruar e nuk trajtohet ai ujë me klor, nuk kujdeset askush me të, sa shpesh Instituti ka marrë mundin le të themi ose e ka bërë detyrën që të dalë në terren dhe ta shoh këtë aspektin e cilësisë së ujit për ata njerëz që marrin nga këto burime të cilat nuk janë të integruar në kuadër të ujësjellësve.

Mendoj që kështu shkojmë te racionaliteti edhe në diskutim edhe marrim informacion të saktë për secilin prej KRU edhe sa i takon ekzistimit të laboratorëve brenda tyre, por edhe mënyrës se si bëhet testimi i analizave përmes Institutit të Shëndetit Publik.

KRYETARI: Kryeje fjalën edhe ti, pastaj na përgjigjet doktoresha.

FILLORETË GASHI-SADIKU: Përshëndetje për të gjitha.

Jam Filloretë Gashi-Sadiku, kryesuese e Bordit KRU Morava Gjilan.

Për të mos marrë shumë kohë, po i përmend disa indikatorë kyq të cilët në fakt e pasqyrojnë gjendjen në të cilën ndodhet ndërmarrja. KRU Hidromorava është përgjithësisht në rrugë të mirë për të krijuar një qëndrueshmëri financiare, sepse është viti i dytë radhazi që operon me fitim financiar. Operativ po se po, po edhe fitim financiar.

Ka rritje të të hyrave, ka rritje të inkasimit më lart sesa faturimi, që tregon se jemi duke mbledhur edhe borxhe të vjetra, rrjedhimisht zvogëlim të llogarive të arkëtueshme, të cilat janë grumbulluar me vite. Edhe përkundër rritjes së shpenzimeve që është evidente në çdo sferë dhe ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve për kompaninë Hidromorava, kompania prapë ka arritur të dalë me fitim.

Qëndrojmë shumë mirë me efikasitetin e stafit, mirëpo sfidë për krejt kompanitë janë humbjet e ujit. Në v. 2023 e kemi përmbyllur me 51,99 që ta rrumbullakojë 52. Por, ajo që kisha pasur dëshirë ta ngre, është që te humbjet e ujit, u diskutua që raportimet e mëhershme kanë qenë jo të sakta. Krahasimi që e bëjnë vitin 2023 me vitet e mëhershme, nuk është shumë relevante, sepse baza me të cilën krahasohemi, nuk ka qenë reale.

Përderisa nuk kemi pasur një bazë reale, nuk e dimë a jemi duke shkuar mirë a keq. Kur të kalojnë dy-tri vite që humbjet e ujit maten realisht, atëherë mund ta bëjmë krahasimin me vitet paraprake.

Sa i përket investimeve kapitale të përcaktuar me proces tarifor, ne i kemi arritur diku 61 për qind. Për KRU Hidromorava, në masë të madhe ka ndikuar edhe procesi i tenderimit, sepse janë disa projekte të cilat do të mund të realizoheshin në fundvit dhe e kishin rritur këtë përqindje.

Opinion i Auditorit për v. 2022 ka qenë opinion i modifikuar për dallim prej viteve të mëhershme që ka qenë opinion....

Nuk po ju marr më shumë kohë për gjendjen e përgjithshme...

KRYETARI: Urdhëro deputete, fjala për ju.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Po më vjen mirë që Gjilani doli me performansë pak më të mirë.

Një problem është që raportet janë sisteme të gatshme, po ujë të pijshëm nuk ka nëpër ato lagje. Kjo pyetje vlen edhe për Gjilanin. Konkretisht te rruga e Prishtinës, ka qytetarë në Gjilan, që gypat i kanë dhe ujësjellësi nuk u shkon.

Nëse flasim për investime kapitale, që qenkan 61 për qind, atëherë qysh mund të funksionalizohen këta gypa që ekzistojnë dhe a janë në gjendje gatishmërie dhe a duhet investuar prapë, edhe pse ekzistojnë gypat ku nuk kanë ujë të pijshëm qytetarët, po i shfrytëzojnë pusët, pikërisht në lagjen ku unë jam.

Ne kemi shkuar edhe në vizitë në Gjilan dhe kemi kërkuar që këto lagje që i kanë gypat, të investohet dhe thjeshtë të furnizohen me ujë të pijes. Është thënë se duhet një pusëtë në një lokacion për të pasur rënie të lirë.

Pyetja ime konkrete për të gjithë është: qysh ka mundësi që të investohet që edhe pse janë gypat të furnizohen qytetarët me ujë?

YMER SALIHU: Përshëndetje për të gjithë,

Unë jam Ymer Salihu, kryeshef ekzekutiv në KRU Hidromorava Gjilan. Sa i përket Gjilanit, për rrugën që e përmende, parashihet në projektin Flows, që të ndërrohet komplet ajo trase e gypit dhe të vendoset gypi i ri. Tash, për momentin ajo lagje ka ujë, për shkak se ka ujë të mjaftueshëm. Më herët ka pasur mungesa për shkak të shtypjes së vogël.

Është e vërtetë që duhet ndërtuar edhe një pusëtë aty sipas inxhinierëve të kompanisë për të mundësuar që edhe në viset më të larta të ketë ujë rregullisht 24 orë. Edhe gypi momental, edhe pse është i vjetër dhe me asbest, uji qarkullon atje.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Kryeshef!

Edhe kryeshefi i mëhershëm, gjithmonë është thirrur në këtë projektin Flowers, edhe nuk ka ujë. Gypi ekziston, po shtypje s'ka. Pikërisht unë jam në atë lagje. Ne, gjithë lagjja, d.m.th. prej fillimit të rrugës qarkore deri kah mesi përtej tunelit, nuk kanë ujë të pijshëm ata qytetarë. Ata i shfrytëzojnë bunarët e veta. Sepse, në qoftë se ekziston gypi dhe vjen uji tepër pak, atëherë nuk mund qytetarët të kenë ujësjellës.

Sa i përket pusetave dhe këtij programi, unë vetëm po pyes sinqerisht, se kështu po mendojmë që me menaxhmentin e ri do të përmirësohet më dukshëm, sepse menaxhmenti i kaluar as që është marrë me këtë problem. Publikisht e kam thënë. Nuk është interesimi im cili menaxhment po e kryen punën. Mua më intereson që qytetarët e Gjilanit të kenë ujë dhe ta shfrytëzojnë ujësjellësin. Gypat janë, po ujë nuk ka. Nuk mund të themi se e shfrytëzojnë ujin. Të ujësjellësit. Jo. Këtë e di qind për qind.

YMER SALIHU: Atëherë po ju njoftoj edhe një herë që projekti... është e vërtetë që ka zgjatur shumë, prej v. 2019. Edhe tash veç është në fazën përfundimtare. D.t.th. jemi në fazën e tenderimit dhe kjo fazë do të zgjasë diku gjashtëdhjetë ditë, edhe menjëherë pastaj do të fillojnë punimet. Besoj që edhe kjo lagje në të ardhmen do të marrë ujë rregullisht 24 orë. Për momentin, faktikisht Liqeni i Përlepticës është i mbushur me ujë dhe kemi kapacitete. Përndryshe, d.m.th. vitet e kaluara, edhe ju e dini vet se ka qenë shumë krizë e madhe në Gjilan për ujë dhe është vështirë zonat e larta t'i furnizojmë me ujë. Personalisht do të interesohem edhe për lagjen e Prishtinës, sepse për shkak të bazë të inxhinierëve, thonë se këta marrin ujë, po ndoshta veç që janë të lidhur me bunarë dhe për shkak se janë mësuar të marrin prej burimeve të veta.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Nuk kanë ujë, kështu që bindu dhe verifikojeni tekefundit. Unë ju përgëzoj si menaxhment, ishalla shpejt kryhet, sepse interesimi është që qytetarët ta shfrytëzojnë ujësjellësin, sepse midis qyteti nuk kemi ujësjellës a në fshatra malore i keni dërguar ujësjellësin.

KRYETARI: Vetëm pak po shkojmë me radhë.

Drejtoresha u përgjigjet pyetjeve fillimisht, pastaj shkojmë Dërmaku, pastaj ju.

BURBUQE NUSHI: Konkretisht, në pyetjen tuaj: a monitorohet apo a kontrollohet cilësia e ujit në regjionet të cilat nuk kanë rrjet të shtrirë ose menaxhim të kompanisë për furnizim me ujë. Në misionin tonë të Institutit është mbrojtja dhe avancimi i popullatës. Çdoherë, çdo vit, katër herë

në vit bëhen analizat ose përcjellja e cilësisë së ujit në regjionet të cilat nuk janë të kyçura në sistemin qendror të furnizimit të ujit.

Kjo është me rregulloren tonë, katër herë në vit. Prej tyre, çdo tremestër, në bashkëpunim a bashkëveprim me Kuvendin Komunal, Departamentin e Shëndetësisë, aty merren dhjetë fshatra të cilat nuk janë të kyçura në sistem qendror të furnizimit me ujë. Prej tyre, në secilin fshat bëhen dy pika në monitorim të cilësisë. Kryesisht prioritet kanë shkollat, ambulancat, apo edhe me indikacion epidemiologjik nëse ka ndonjë familje me indikacion epidemiologjik. Kjo është rregull që bëhet.

Mirëpo, po ju njoftoj se shumë shpesh bëjmë analiza dhe e përcjellim cilësinë në këtë regjion dhe në përgjigje si indikacion epidemiologjik në bazë të kërkesës së qytetarëve, apo në bazë të rritjes së numrit të sëmundjeve.

T'ju them, jo për t'ju frikësuar, se më ka dalë zëri i zi që po frikësoj. Po e shoh që s'jeni duke u frikësuar fort, po zoti deputet, sëmundshmëria me diarre ende në Kosovë sot është pesëdhjetë për qind. Diarre është sëmundje ngjitëse që llogaritet si sëmundje hidrike. Rreth pesëdhjetë për qind në shek. XXI, ende kemi pesëdhjetë për qind diarre.

Çka është më keq, deri tash problematika e shëndetit publik ose sëmundshmëria ka ardhur prej këtyre regjioneve që janë të pamenaxhuara. Tash kemi filluar që edhe në qytet të kemi telashe. Viteve të fundit po kemi telashe shumë më të mëdha në qytete të mëdha sesa nëpër regjionet e tjera.

KRYETARI: Faleminderit!

Dërmaku kërkoi më herët, por po ju japim përparësi.

SHIQERI DËRMAKU: Unë jam Shiqeri Dërmaku, udhëheqës i Divizionit të Ujërave në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor e Infrastrukturës, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave.

Unë do të flas sipas kompetencave që i ka njësia ime. Kjo është se kompetencat janë kryesisht rregullative dhe monitorimit të zbatimit rregullativ në menaxhimin e resurseve ujore.

Çështja e ujërave fillon nga neni 122.2 i Kushtetutës së Kosovës deri në aktin e fundit juridik që lëshohet përmes akteve a lejeve ujore. D.m.th. në kuadër të këtyre përshihen krejt.

Në aspektin rregullativ, Kosova për herë të parë në v. 1976 e ka hartuar një Ligj të ujërave, i cili i ka pasur diku 198 dispozita rregullative. Dihet shkaqet e arsytet, është shfuqizuar ai ligj. Në vitin 2004, Kosova e ka hartuar një ligj tjetër, që në aspektin rregullativ konsiderohet i mangët me 84

nene. Në vitin 2013 e ka hartuar ligjin aktual që është në fuqi me 113 nene. Tash momentalisht, jemi në proces të hartimit të ligjit të ri të fushës së ujërave, nga i cili janë dy ligje, është Ligji për menaxhimin e resurseve ujore dhe Ligji për financimin e menaxhimit të resurseve ujore, që në kuadër të këtyre dy ligjeve përfshihen rreth dyqind dispozita rregullative. D.m.th. tash jemi në krahasim edhe me regjionin, jemi në nivel dhe në njëfarë mënyre jemi pak mbi mesataren në aspektin rregullativ sipas legjislacionit që do të vijë në Parlament, besoj së shpejti. Kjo është çështja. Do të thotë, vetëm në aspektin kushtetues dhe të ligjeve ku jemi. Shikoni! Ligji aktual i ujërave i ka 18 akte nënligjore, të cilat janë të nxjerra dhe prej 2016 janë në fuqi. Përveç atyre 18 akteve nënligjore, janë edhe 20 dokumente të tjera legjislative të cilat nuk janë hartuar të gjitha, mirëpo fatmirësisht këto planet e menaxhimit të pellgjeve ujore janë në procedurë të formalizimit.

Janë vonuar, mirëpo janë në procedurë të formalizimit. Thash është çështje muajsh kur do të hipin në fuqi planet.

Tash, si do të ndodh ai menaxhimi? Menaxhimi do të ndodh përmes planit. Do të thotë, në mungesë të këtyre dokumentacioneve, i gjithë menaxhimi i resurseve ujore, përfshirë edhe furnizimin me ujë dhe kohë, nuk ka pasur dokumente bazike kur është bërë. Por, ja në njëfarë mënyre këto mund të quhet, kanë qenë menaxhime, u janë përshtatur situatave dhe në njëfarë mënyre...

Do të thotë, planet pritet brenda 5-6 muajve, po them unë, ndoshta edhe më shpejtë të aprovohen. Kjo është ajo ana legjislative. Domethënë, nuk ka mungesë, nuk ka vakum. Legjislacionet ekzistojnë, por tash veç duhet të zbatohen. Tash, te zbatimi lindin problemet. Problemet janë edhe të kapacitetit të standardeve. Edhe të ngritjes së personelit, i cili menaxhon me ato.

Domethënë, kemi probleme elementare. Ju thashë se sektori i ujërave është një sektor i ri në aspektin menaxhial në Kosovë. Ka filluar vetëm në vitin 1976 formalisht të rregullohen këto çështje.

Tash, te zbatimi i legjislacionit. Është Strategjia shtetërore e ujërave e cila është rishikuar. Do të thotë, aty, në kuadër të kësaj edhe investimet kapitale. Do të thotë, as ajo strategji, domethënë, duhet të zbatohet. Do të shkojmë sipas saj. Planet pritet të realizohen. Të gjitha këto dokumente menaxhohen me të drejtën ujore. Kur jemi te problemi kryesor që do ta kemi.

Tash, e drejta ujore nuk varet vetëm nga legjislacioni i ujërave. Është te investime kapitale, legjislacion shumë kompetent që ndërlihet me legjislacionin e ujërave është legjislacioni i ndërtimit. Ne kemi pasur disa komisione dhe kemi bërë disa analiza të investimeve kapitale.

Kualiteti i ndërtimit edhe në aspektin procedural, mirëpo edhe në aspektin e zbatimit të legjislacionit material nuk ka qenë i duhuri, edhe tash kemi probleme. Dhe, këto janë ato standardet. Sipas të drejtave ujore, ju e dini, ne i lëshojmë aktet ujore, rregullohet çdo gjë. Kjo rregullon edhe furnizimin me ujë e të drejta ujore.

Mirëpo, fillimisht kur KRU-të kanë kërkuar të drejtën ujore, diku në vitin 2006 ose 2007, në njëfarë mënyrë u është lëshuar e drejta ujore, leja ujore u ka lëshuar pa pasur kohë të analizohet fort edhe pa pasur kohë ata ta prezantojnë gjendjen reale me dokumente.

KRYETARI: Mundësisht, kohën pak! Më fal, të lutem!

SHIQERI DËRMAKU: Po! Do të thotë, ajo është një mangësi. Edhe ende sot nuk dihet fort mirë dokumentacioni i atyre kompanive, zyrtarët të cilët kanë qenë kompetentë që të shqyrtojnë të drejtat ujore nuk është i kompletuar. Do të thotë, nuk dihet ajo...Ende nuk dihet. Në bazë të tyre pastaj bëhet edhe ngarkesa e tarifave që ka probleme.

Të çështja e zonave të mbrojtura ujore edhe elaboratet zona ujore. Ato nuk janë. Asnjë kompani s'i ka hartuar. Do të thotë, ajo është shumë e rëndësishme për sigurinë e konsumatorëve të ujit. Domethënë, nuk janë. Tash edhe nuk e di pse s'janë. S'ka ndonjë farë arsye. Nuk mund të kushtojnë shtrenjtë ato. Nuk e di. S'di edhe a ka pasur kërkesa financiare që të bëhen ato.

Ato nuk ekzistojnë. Ajo është sfidë. Ato duhet të kryhen se për çdo ditë që vazhdojnë ata ato elaborate, jemi të pasigurt. Këto janë ato. Një kërkesë që po dua ta përmend që e përmenda legjislacionin e ndërtimit te investimet kapitale problematik është Ligji i ndërtimit. Kisha apeluar tash. Frik tash është bërë një ekspost i Ligjit të ndërtimit, ku janë dhënë rekomandimet, ku do të ndërrohet ligji në fuqi i ndërtimit, është çështja e projektimit, revidimit të projektimit dhe mbikëqyrjes nga pala e tretë. Këto i kanë munguar Ligjit aktual në fuqi të ndërtimit.

Besoj, tash kompletimi i ri i Ligjit të ndërtimit shumë çështje do t'i zgjidhë, se ndërtimi edhe objektet ujore hyjnë në fushën e ndërtimit. Ato nuk janë zgjidhur. Ne kemi pasur, e keni parë, probleme me hidrocentral e ka luajtur pozicionin, nga atje ka shkuar këtu. Ato kompetenca ka qenë për shembull të Ligjit të ndërtimit. Se Ligji i ujërave menaxhon vetëm regjimin, mirëpo edhe pozicionet e pronat e këto. Aty kanë munguar tre persona.

KRYETARI: Kërkoj mirëkuptim! Zoti Hafizi e keni fjalën, sepse kam kërkesa që kohën ta shkurtojmë.

NASER HAFIZI: Faleminderit! Unë jam Naser Hafizi. Jam udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përschëndes Komisionin për Ekonomi, Industri, Tregti dhe Ndërmarrësi. Të gjithë deputetët prezentë dhe të gjithë të tjerët prezentë prej KRU-ve, prej Këshillit ndërministror, prej Ministrisë së Ekonomisë, auditorët e të tjerët. Përschëndetje për të gjithë.

Po e shoh që debati tërë kohën është orientuar më shumë në furnizim me ujë të pijes. Te humbjet, së fundi edhe te kualiteti i ujit të pijes, mirëpo menaxhimi i ujërave ka shumë më shumë komponentë.

Ministria e Mjedisit, në kuadër të saj departamenti përgjegjës të cilin unë e menaxhoj, është përgjegjës për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtën nga ujërat, që janë vërshimet.

Në kuadër të këtyre komponentëve në aspektin e mbrojtjes së ujërave, unë mendoj që sfida kryesore e kemi mbrojtjen e lumenjve. Mbrojtja e lumenjve në Kosovë çalon ose është e atakuar nga shumë keqpërdorues të ndryshëm, qoftë me mbeturina, qoftë me shkarkime të ndryshme, të cilat ndoshta përmes projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në disa qytete ka filluar pak a shumë të menaxhohet, mirëpo kjo ka qenë sfida e madhe e pasluftës të cilën nuk ka arritur Kosova ta menaxhojë siç duhet, por kësaj i paraprinë edhe një mungesë e vetëdijesimit ose ndërgjegjes qytetare, të cilën edhe atë nuk kemi arritur përmes kampanjave, fushatave të ndryshme ta menaxhojmë siç duhet.

Në këtë pikë mendoj që duhet të bëjmë shumë më shumë të gjithë së bashku edhe si institucione edhe si KRU, por edhe si organizata të ndryshme joqeveritare.

Sfidë e madhe në këtë 20-vjeçar ka qenë mungesa e planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore që e përmendi kolegu paraprak para meje. Dhe, tani i kemi të finalizuara dhe pritët brenda këtij muaji, eventualisht muajit maj të aprovohen dhe të fillojmë të menaxhojmë ujë në nivel të pellgjeve përmes planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore, gjë që në vitin 2004 kur ka qenë në fuqi ligji i parë i pasluftës i ujërave, i ka paraparë që të hartohen ato plane brenda 18 muajve, diku 2005-2006 do të duhej të ishin të gatshme, ndërsa ne jemi në vitin 2024, ende janë planet e para të aprovuara, por presim shumë shpejt dhe kjo ka qenë një e arritur shumë e madhe si shtet edhe si sektor i ujërave.

Nëse keni durim t'i përmend disa nga rezultatet apo vetëm për sfidat po flasim.

KRYETARI: Flasim për sfidat, se nëse i përmendim rezultatet tani hapet debat tjetër. Po shkojmë për sfidat, sepse qëllimi ynë është që ta përmirësojmë sektorin.

NASER HAFIZI: Më herët quhej sfida, por është njëlloj vakumi, ku tash janë prezentë të gjithë aktorët e KRU-ve ose përfaqësuesit të cilët aktualisht nuk kanë leje valide për shfrytëzimin e

ujërave. Domethënë, u ka skaduar vitin e kaluar dhe tash janë në proces. Unë kisha kërkuar prej këtyre të hartojnë elaboratet për zonat e mbrojtura, që i përmendi kolegu më herët për KRU-në Gjakova. Domethënë, është obligim i KRU-ve të hartojnë elaboratet për zonat e mbrojtura sanitare dhe njëkohësisht edhe disa obligime të tjera që i kanë, qoftë financiare, sepse përmenden që kanë suksese në të hyra në inkasim, mirëpo është mirë të paguhen edhe obligimet shtetërore që i kanë.

Këtu është edhe kryeshefi i KRU Prishtina i cili ka më së shumti obligime, edhe është kompania më e madhe që të fillojë me radhë.

Edhe këtë sfidë po e përmendi, mandej mundeni me pyetje përgjigje. Shumë më mirë funksionin kur keni pyetje konkrete sesa të elaborojmë kështu teoritë të ndryshme të thata.

KRYETARI: Faleminderit! A do të vazhdosh?

NASER HAFIZI: Desha të flas edhe për vërshimet, sepse kemi pasur vitin kaluar një vit shumë sfidues të të reshurave dhe ne si ministri tani jemi duke finalizuar një proces të themelimit të hartave të rrezikshmërisë nga përmytjet dhe rrezikut nga vërshimet që do t'u shërbejë edhe KRU-ve, por edhe më shumë komunave, por edhe ministrisë.

Kjo ka qenë një sfidë të cilën jemi duke u munduar ta menaxhojmë. Faleminderit! Nëse ka pyetje dikush.

KRYETARI: A e do fjalën dikush? Po shkojmë te drejtori i menaxhimit të ndërmarrjeve, pastaj fjala për ju.

VALON PREBREZA: Përshëndetje për të gjithë!
Unë jam Valon Prebreza. Po më vjen keq që deputetja doli, por ne jse.

KRYETARI: Vazhdo ti! Jam unë këtu, të mos mërzhitesh. Vazhdo.

VALON PREBREZA: Veç desha të tregoj se kemi filluar investimet nëpër ndërmarrje, sidomos te Gjilani prej momentit që ka filluar kompania e Gjilanit të shoh, se të mos shpenzohen paratë në tenderët kot, edhe ne e kemi parë të arsyeshme t'u ndihmojmë. Këtë vit planifikojmë afërisht 1 milion euro investime kapitale në këtë ndërmarrje.

Duke përfshirë, ta zëmë, komplet rrjetin e fshati Cernicë. Ndërtimin e kyçjeve në fshatin Shipashnicë. Fabrikën e ujit në fshatin Velekincë. Karaçevën e Epërme. Po ashtu, vlen të theksohet që bifurkacionit të Ferizajt në këtë vit do t'i ndihmojmë me 620 mijë euro, ku do ta marrim edhe si pilot-projekt qytetin e Ferizajt për ta festuar investimin e bërë në digjitalizim dhe

në ngritjen e cilësisë së shërbimet e ujësjellësit, ku mandej të gjitha kompanitë rajonale do ta marrin si model për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

KRU Mitrovicën, siç e dimë të gjithë, e kemi një problem të veçantë atje, duke filluar nga problemi politik që kemi të bëjmë me pjesën veriore, shtu këtu që edhe komunat e tjera, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Vushtrrisë, po ashtu edhe e Skenderajt, na kanë bërë pengesa në investimet në ato pjesë, në zonën ku ata operojnë.

Prandaj, kemi pasur telashe me komunat. Te KRU Prishtina e kemi vlerën e investimeve mbi 1 milion e 600 mijë euro. Duke filluar nga Fushë Kosova, Shtime, Graçanicë, në fshatrat e Podujevës, Orllan, Turiqicë, Kalaticë. Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Herticë. Po ashtu hapjen dhe furnizimin e puseve në Shtime. Vlen të theksohet po ashtu që furnizimi për fshatrat e Fushë Kosovës, duke filluar nga fshati Grabovc, Bardh i Madh, Mesbardh, Bardh i Vogël dhe Lismir, do të bëhet me 24 orë furnizim, që mendojmë që në vitin e ardhshëm ky projekt do të finalizohet.

Vlen të theksohet që KRU Gjakovën në këtë vit do ta financojmë me 1 milion e 400 mijë euro, ku Gjakova me projektet e tyre do të shtrijmë rrjetin në Gjakova 3, në fshatrat Lugbunar, Osek Hilë, po ashtu Hoçë e Madhe me rrethinë. Gjithashtu, edhe Krushën e Madhe, Piranë, Zajs dhe Medec.

Hidroregjionin e Prizrenit do ta ndihmojmë me 100 mijë euro për fshatin Gërmqarë që është si fshat i komunitetit. I përmenda këtu, duke shtuar edhe vlerën e investimeve vetanake që do ta kenë kompanitë e ujësjellësit, që aferist kur t'i mbledhim në total del afër 11 milionë euro. 5,5 milionë janë të Ministrisë së Ekonomisë.

Po ashtu si sfida e veçantë e këtij sektori po vlerësojmë që duhen aktorë të ndryshëm të jenë të implikuar, duke filluar nga ministritë e linjës, qoftë Ministria e Mjedisit, Ministra e Ekonomisë, Autoriteti Rregullativ. Po ashtu edhe ju si komision ndërministror për të gjetur zgjidhje për këtë sektor.

Këtë që e tha Batoni që në këto vite është punuar. Po. Fakt është punuar. Ka përmirësime në fusha të caktuara nuk është që s'është punuar, mirëpo a ka mundur të punohet më mirë? Po, ka mundur të punohet më mirë. A ka mundur paraja publike të mos keqpërdoret? A ka mundur që shërbimet të jenë më cilësore? Po, ka mundur.

Tash, nuk e di pse kryeshefat këtu fort nuk hyrën në këtë temë, mirëpo unë i kam informacionet i kam prej kryeshefëve, duke filluar, ta zëmë, në Hidro Drinin e Pejës, ne kemi pasur telashe prej aktorëve politikë atje. Fabrika e ujit atje, fabrika e ujit që merr ujë nga ujësjellësi dhe vetëm e paketon dhe e shet. Ndotja që u bëhet atje lumenjve. Në Prizren Abi Qarshinë e kemi po ashtu si

problem që mendoj që është çështje komplet politike që s'ka ndikuar deri tash kurrë. E ujësjellësit e tjerë në përgjithësi, që nuk po dua tash të hyjë në detaje.

Mendoj që si sfidë...Mos e teprova dokoreshë? Aha, fire on. Thashë mos e teprova. Edhe problemin e manganit që e kemi pasur vitin e kaluar, po besoj që këtu edhe dokoresha mund të na ndihmojë, kemi ardhur te një zgjidhje që mendojmë së bashku me Ibër Lepencin edhe KRU Prishtinën ta ofrojmë furnizimin për liqenin e Badovcit direkt nga liqeni.

Këto janë vetëm si ide, pastaj ekspertët do ta japin mendimin dhe vlerësimin e tyre. Ju faleminderit që më dëgjuat!

MENTOR SEJDIU: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për fjalën! Mentor Sejdiu, udhëheqës për çështje ligjore nga ujësjellësi i Mitrovicës. Po ndalem direkt te tema, te sfidat për ta kursyer kohën.

Siç u cek edhe më herët, humbjet edhe te ne janë bajagi të larta. Rastet sociale janë pengesë. Rastet e cenueshme. Domethënë, kisha kërkuar që të gjitha ato lista, të cilat Qeveria i mbulon për shpenzim të energjisë t'i mbulojë edhe për shpenzim të ujit. Ndërsa, si sfidë kryesore e Ujësjellësit të Mitrovicës, është pjesa veriore.

Domethënë, shpenzime mujore i kemi për afërsisht 80 mijë euro në muaj për shitjen e ujit me shumicë, të cilat faturohen, por nuk mbulohen e për të cilat ne si kompani paguajmë edhe TVSH, paguajmë edhe ujin e blerë me shumicë prej Ibër Lepencit për këto.

Andaj, pjesa veriore për neve është sfidë kryesore e cila ka ndikuar edhe te pagat, ku i kemi më të ulëtat prej krejt kompanive. Tjetra. Pagat e ulëta kanë ndikuar që shumica e pozitive udhëheqëse të jem me ushtrues detyre për arsye se nuk vijnë persona adekuat. Domethënë kur i shikosh pagat. Edhe kjo ka ndikuar edhe në investime kapitale. Diçka tjetër s'kam.

KRYETARI: Faleminderit! Po shkojmë kah fundi. Dhe nëse ka dikush vërejtje, sugjerim. Vetëm pak ta përfundoj unë një herë, më fal! Pastaj në fund, sigurisht edhe zëvendësministri pak, drejtoresha e ARRU-së së bashku me mua do ta përmbyllim me ndonjë qëndrim të përbashkët.

Unë e dëgjova shumë propozime, ide dhe sigurisht që nuk do të jetë takimi i fundit, por ne do të kemi mundësi që ta bëjmë një planifikim tjetër. Urdhëro! Veç mundësisht konkretisht.

FADIL BERISHA: Shumë shkurt! Vetëm se unë po e shfrytëzoj rastin se harrova për shkak të menaxhimit të kohës ta potencoj. T'i kemi të gjithë aktorët relevantë këtu. Unë kisha kërkuar që lejet ujore që janë lëshuar për kompanitë. I dimë ato proceset që i kërkuat që të plotësohet dokumentacioni i plotë.

Pyetja ime është konkrete. A kontrollohen bizneset nëpër qytete të cilat nuk janë më konsumatorë tanët, me arsyetim që kanë puse edhe nuk e shfrytëzojnë më ujin tonë. A shfrytëzohen nga institucionet përkatëse prej Autoritetit Rregullativ edhe nga ministria, sepse këtu është një dëm shumë i madh që i kanë shkaktuar kompanisë.

Në rastin konkret, kompanisë sonë. Sepse kemi humbur konsumatorë shumë të mëdhenj potencialë edhe nga aspekti financiar. Edhe gjithmonë ata, po e them zyrtarisht, ata thonë që kanë puse edhe shfrytëzojnë në bazë të një leje që ata e kanë.

Pyetja ime edhe njëherë konkret: a kontrollohen këto biznese? Edhe a kanë leje, edhe pse Autoriteti Rregullativ kështu zyrtarisht më kanë thënë që s'kanë leje nga Autoriteti Rregullativ. Por, po u drejtohem nga ministra, a kanë leje nga ministria që këto biznese të shfrytëzojnë ujin prej puseve?

NASER HAFIZI: Biznese të caktuara të cilat kanë puse të veçanta, e të cilat nuk furnizohen prej ujësjellësve posedojnë leje shumica, se ka edhe që nuk kanë leje. Shumica posedojnë leje prej ministrisë dhe kontrollohen edhe raportojnë në baza sipas ligjit. Ka qenë tre muaj. Tash me udhëzimin e ri administrativ është në baza vjetore.

Çdo fillim të viti raportohet për sasinë e shfrytëzuar të ujit për vitin paraprak deri më 15 janar.

KRYETARI: Unë desha një pyetje sqaruese për Sekretariatit ose Këshillin. Begolli e përmendi një afat. Realisht nuk e kuptova. A thatë të mandatit tuaj apo të kujt nuk e kuptova atë. Edhe e përmende një takim të ardhshëm. Do të thotë, unë me kënaqësi do të isha pjesë e takimit, por edhe njëlloj raporti pa marrë parasysh si rrjedhë situata do të ishte mirë tepër që komisioni ta ketë raportin tuaj, që ju iu referuat në atë takim përmbyllës ta kemi.

BATON BEGOLLI: Ne e përfundojmë mandatin si këshilltarë të Këshillit ndërministror më 30 prill. Rrjedhimisht, kemi kërkuar së bashku me donatorin që e ka financuar përkrahjen tonë pranë Këshillit, ta bëjmë një takim përmbyllës ku do t'i japin të gjitha të arriturat, problemet dhe çka mendojmë që duhet të ndodh më tutje në sektorin e ujërave dhe atë takim e mbajmë apo s'e mbajmë, përcillet me një raport të cilin është e kërkesë edhe financuesit për ta ndarë të gjithë hisedarët e sektorit.

KRYETARI: Në emër të komisionit dhe unë si kryetar, do të thotë, pa marrë parasysh qysh, ne jemi të interesuar në takimin përmbyllës apo paraprakisht vetëm ju me komisionin që të kemi këtë temë, sepse për ne është shumë me rëndësi të shohim se çka po ndodh dhe çka realisht mund...

BATON BEGOLLI: Vetëm një sqarim. Takimi ynë përmbyllës është me klientin tonë ku është Qeveria e Kosovës. Por, natyrisht mendojmë t'i ftojme të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të ujërave, hisedarët.

KRYETARI: Po nëse diçka ndryshon do të thotë të mos na kurseni, sepse për neve është shumë me interes që të jemi pjesë e kësaj. Këtë desha ta them. Edhe diçka me drejtorin e menaxhimit të ndërmarrjes. Drejtor, ju iu referut, së paku dy rasteve që për mua janë interes t'i di dhe të kem informacion.

Nuk po them sot, por kisha kërkuar nëse ka mundësi edhe është mirë të na shpjeguar edhe zyrtarisht çështjen e pengesës së një komune atje, dhe çështjen e Pejës do të thotë. S'po them sot, por komisionin është mirë të informohet, edhe ashtu ju raportoni te Komisioni për Ekonomi, ta kemi një informatë të shkruar se cila komunë, cili aktor politik projektet e kësaj natyre nuk besoj që duhet t'i tolerojmë e as t'i lejojmë që ne, si të themi, të luajmë në këtë aspekt, sepse uji nuk është politik.

E tha Dërmaku më herët, është kategori kushtetuese dhe është çështje tjetër, kështu që, sot s'po dua të qelën ato, po komisioni është mirë ta ketë një informatë të shkruar, sepse janë çështje jashtëzakonisht të ndjeshme.

Para se ta mbyll unë, unë po e mbyll fjalën time, pastaj prapë mund të vazhdojë edhe Dritoni edhe krejt. Do të thotë, të gjitha vërejtjet, sugjerimet, propozimet, veçanërisht alternativat për zgjidhjen e sfidave që keni, ne i presim për një afat kohor maksimum 10 ditore si komision. Para se të nxjerrim gjithë spektrin e këtyre që i diskutuam.

Do të thotë, brenda një afati 10 ditore, koordinatorit të komisionit për të gjitha këto sfida që i keni, ju lutem t'i drejtoheni edhe me shkrim. Ato që i keni thënë këtu, në rregull, i kemi ne. Por, nëse ka diçka që në ndërkohë duhet t'ia përcillni komisioni që ne të dalim sa më përmbyllës në këtë punë, të gjitha institucionet që jeni këtu, 10 ditë afat të dakorduar bashkërisht që ne t'i marrim të gjitha, si të themi, kërkesat dhe sfidat apo alternativat e zgjedhjeve.

Të çështja e legjislacionit, ekzekutivit, meqë e kemi këtu. Vërtet është mirë, nuk e di tash u përmend nga Dërmaku dhe disa të tjerë, që janë në fazën e trajtimit të plotësim-ndryshimit të ligjeve. Edhe këto, sigurisht që ato do të vijnë nga ne, por paraprakisht mirë është ta kemi një informatë deri ku jemi.

Ne e kemi pasur një nismë tonën të bëjmë diçka te Ligji i ujërave, por për shkak që nuk kemi dashur shumë të ngutemi dhe të ndërhyjmë tek Ekzekutivi apo te planet e tjera, pikërisht për disa sfida që kemi pasur edhe me ARRU-në jemi vonuar pak me ligjin, por po e presim nëse veç janë në plotësim-ndryshimit të ligjit.

Po ashtu Ligji i ndërtimeve që e përmendet e ndikon, gjegjësisht e afekton atë a është proces apo është veç ide. Nuk është në plan këtë vit.

Driton, pate diçka të shtosh, pastaj zëvendësministër, a keni diçka për fjalën përmbyllëse.

DRITON HYSENI: Zëvendësministër, veç lidhur me çështjet që ngrita më herët edhe t'i informojë KRU-të që si komision kemi marrë vendim që këtë sesion pranveror ta bëjmë monitorimin e funksionimit të Ligjit për ndërmarrjet publike. Në këtë rast, aty hyjnë edhe KRU-të. Ne së shpejti do të vëmë kontakte dhe do të vijmë në detaje të bisedojmë si grup i komisionit.

Unë e kryesoj grupin me të gjitha KRU-të që janë funksionale në vend. Po besoj kjo gjithpërfshirja këtu mirë na bën, po edhe na zgjat ndoshta në kohë që të vijnë në konkluzione shumë të qarta. Mirë që e kemi transkriptin e diskutimeve tash, edhe komentet që mund t'i dërgoni siç edhe kryetari, në afat brenda 10 ditëve, dhe mandej ne shkojmë nëpër to edhe shohim se cilat janë nevojat edhe ne si deputetë kemi nevojë që ta kryejmë rolin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'i adresojë çështjen që u ngritën.

Mendoj që është e rëndësishme meqë jemi të gjithë këtu prej secilit nga përfaqësuesit e KRU-ve që janë këtu ta dimë edhe njëherë se cila është mënyra e garantimi të cilësisë së ujit. A kanë laborator brenda vet KRU-së? Cili është bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik? Sa shpesh bëhet testimi i mostrave? Cila janë rezultatet? Edhe në rastet kur ka rezultate jo të mira, a përsëritet mostra apo ka ndërprerje të shërbimit të ujit. Kjo mendoj se është shumë thelbësore ta kemi sot në pika sa më të shkurtra se unë e di që ndoshta u zgjat diskutimi këtu, mirëpo thjesht kur kemi gjithpërfshirje kështu normalisht edhe diskutimi na merr kohë pak më shumë.

Mendoj që është e rëndësishme ta kemi këtë të qartë për arsye se e heqim një dilemë edhe ne si anëtarë të komisionit që e mbikëqyrim sektorin sa i takon cilësisë së ujit që u ofrohet njerëzve, qytetarëve të vendit.

BURBUQE NUSHI: Faleminderit deputet, në pyetjen ose në çështjen që e ngrite. Por, pak më herët unë u deklarova se thashë kemi udhëzim administrativ për monitorimin e cilësisë së ujit. Krejt këto janë çështje të cilat ju i ngritët tash, janë të rregulluara me akte juridike me akte ligjore.

Do të thotë, është përgjegjësia e kompanisë edhe përgjegjësia e institutit. Çdo gjë është e akorduar ashtu në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit, i cili e transpozon direktivën evropiane.

Sa u përket laboratorëve të gjitha kompanitë duhet të kenë laboratorë. Shumica i kanë ose të mos them të gjithë. Duhet të kenë se udhëzimi e kërkon edhe ato laboratore të akredituar me ISO standarde.

DRITON HYSENI: Faleminderit, doktoreshë!

Atëherë, edhe unë për shkak të racionalitetit po mjaftohem me përgjigjen tënde, vetëm se po kam dëshirë të di pak edhe për nivelin e kualitetit, për cilësinë.

BURBUQE NUSHI: Cilësia e ujit me udhëzim administrativ, tash më duhet të hyjë në udhëzim, s'kam qare. Monitorimi ndahet në monitorimin operacional që është përgjegjësi e kompanisë edhe monitorimin e përputhshmërisë që është përgjegjësi e institutit.

Monitorimi i përputhshmërisë është uji në rubinet. Faktikisht flet për cilësinë e ujit që e pi qytetari, që e pi popullata. Vitin e kaluar, në raportin për 2022, faktikisht edhe 2023 është diku 98, 58% përputhshmëri totale me standardet të cilat kërkohej ose të cilat derivohen, dalin prej udhëzimit administrativ.

Çdo vit, aty është e mira se çdo vit kemi një përmirësim të cilësisë, ose të këtyre rezultateve, përpos vitin 2020-2021, po mendoj kur ka qenë pandemia. Para tri viteve. Aty kemi pasur pak ngecje, përkundër faktit se edhe Ligji për luftimin e sëmundjeve ngjitëse ore Rregullorja për pandeminë, në nenin e parë e ka pasur ofrimi i ujit cilësor për qytetarët.

KRYETARI: Na mbeti pak borxh. Çështja e manganit a është mbyllur? A kemi ndonjë raport zyrtar, a kemi ndonjë qëndrim?

BURBUQE NUSHI: Zoti kryetar, çështja e manganit nuk mbyllet derisa ka ndërime sezonale çdo vit do të kemi telashe me mangan. Nëse nuk investohet, Valoni e përmendi diçka që janë pyetje, janë diçka në projekte për furnizim të Badovcit. Badovci është fenomen natyror. Badovci ndodhet në terren minerar.

KRYETARI: Këtë e di mirë. Por, po më intereson, tash a jeni dakorduar, a do pastrim bazeni a do...

BURBUQE NUSHI: S'ka nevojë pastrim baseni aty. Projekti vazhdon me...

KRYETARI: Po qysh është zgjidhur atëherë? A kemi ndonjë koment rreth kësaj, drejtor?

VALON PREBREZA: Kemi pasur takime të grupeve punuese të KRU Prishtinës edhe Ibër Lepencit, ku jemi dakorduar që të bëhet rehabilitimi apo rindërtimi komplet i gypit të kanalit të

Ibër Lepencit nga fshati Besi. Ose, më tepër mund të na tregojë edhe gjëra teknike, Arsimi, deri në furnizim të fabrikës në Badovc. Por, më konkretisht meqë Arsimi është këtu.

ARSIM FETAHU: Faleminderit! Fillimisht, sa i përket cilësisë i kemi laboratorët. I kemi... Është faza e riakreditimit edhe stafi edhe pajisjet jemi super shumë në nivel. 98.98% është cilësia ujit më 2023.

Sa i përket zgjidhjes së problemit të manganit, mangani qysh e ceku doktoresha, së pari e falënderojmë institutin, edhe pse e kanë obligim, por e kemi një bashkëpunim më shumë se zyrtar, e kemi një bashkëpunim të jashtëzakonshëm, sidomos të rasteve kur kemi probleme si mangani e të tjera.

Zgjidhja e problemit të manganit. Mangani qysh e tha doktoresha, qysh pak a shumë jemi informuar të gjithë, shkaktohet kryesisht në dy sezone. Në sezonin e pranverës dhe në sezonin e vjeshtës. Kështu që, në këto të dyja raste, rritet shkalla e manganit, mirëpo zgjat një periudhë të caktuar kohore.

Për fat të keq gjatë vitit 2023 ka zgjatur një periudhë më të gjatë, pothuajse gati 30 ditë, dhe kjo ka shkaktaur një shqetësim më të madh se herëve të kaluara. Zgjidhja e këtij problemi, kemi biseduar edhe me ministrinë, po edhe me Ibër Lepencin, sasia e ujit që nevojitet për trajtim kur kemi problem me manganin, do të merret nëpërmjet kanalit të Ibër Lepencit dhe do të dërgohet drejtpërdrejt në fabrikë të trajtimit të ujit në Badovc.

Kjo kërkon një kosto investime rreth 5 milionë, të cilën jemi në hapa të gjetjes së zgjidhjes edhe me Ibër Lepencin që e financon pjesën e vet, por edhe KRU-ja së bashku me ministrinë edhe institucionet e tjera për ta gjetur zgjidhjen për financim të këtij projekti.

Me zgjidhjen e këtij projekti, uji ato momente që ka çfarëdo probleme në liqenin e Badovci, uji do të merret nga liqeni i Ujmanit dhe do të shkojë drejtpërdrejt në fabrikë, jo në liqe. Pse po mendon kryetar që zgjidhet?

Për shembull, historikisht nuk ka zgjatur asnjëherë, doktoresha është këtu, më shumë se 10 ditë. Vitin e kaluar ka zgjatur më shumë, mirëpo është problem, qysh tha edhe doktoresha, fenomen natyror. Zgjidhja bëhet, se qytetari nuk mbetet...

KRYETARI: Më lejoni edhe mua t'i jap nja dy komente, sepse unë ju dëgjova.

BURBUQE NUSHI: Më falni! A bën sa i përket cilësisë, të lutem?!

KRYETARI: U bë, u bë.

BURBUQE NUSHI: Zoti kryetar, mangani, paraqitja e manganit është fenomen natyror, stratifikimi i liqenit. Ai është fenomen natyror. Ndodh dy herë në vit, në pranverë edhe në vjeshtë. Për shkak të ngrohjeve, për shkak të çrregullimeve klimatike sivjet ka zgjatur pak më shumë. Çdo vit kemi telashe.

Jo. Se nuk është i pasur. Ju thatë se e dini që është minerar. Mangan ka në Badovc më së shumti, jo në Batllavë. Kështu që, zgjidhja me gyp është vetëm momentale. Vetëm kur kemi telashe me mangan. Përndryshe, sot Badovci s'ka telashe.

ARSIM FETAHU: Me leje! Zgjidhja e problemit të manganit. Veç edhe një fjalë, kryetar! Përveç zgjidhjes së problemit me manganin që është periodik, zgjidhja me Ujman bëhet edhe kur kemi thatësira, gjë që zgjidhje të tjerat nuk na imponohen.

Unë jam kryeshef i KRU Prishtinës. Prishtina po shkon zgjerimin pikërisht në atë pjesë, ku konsumatorët tanë furnizohen nga liqeni i Badovcit. Edhe po themi që u zgjidh.

Të lutem veç problemin e thatësisë nuk e ceke që në shumë raste liqeni i Ujmanit për shkak që sasinë e ujit e ka të kufizuar, liqeni i Ujmanit ju e dini shumë i mirë, i Badovcit e ka edhe ka edhe...kështu që na garanton siguri, çfarëdo problemi që paraqitet.

Edhe nëse më lejon! Që pyete a ka në liqene të tjera mangan. Ka, mirëpo te vepra e marrjes te liqeni i Badovcit e kemi një vepër, te Batllava i ke në tri vepra, në tri nivele edhe nëse paraqitet në nivelin e lartë, ne e marrim të mesëm ose të ulët.

Por, edhe e kundërta. Nëse paraqiten në rastin e ulët, qysh ka qenë në këtë rast ose të mesëm, e marrim në rastin e epërm te Batllava. Kërkoj falje për kohën!

GETOAR MJEKU: Desha te lidhem te deklarimet edhe te shqyrtimet që i ka bërë zoti Dermaku dhe zoti Hafizi, te mbrojtja e Pellgjeve ose lumenjve. E përcakton atë edhe më vonë teknikisht edhe mangani ka zgjidhje. Po bisedojmë se atëherë do ta bëjmë një zgjidhje teknike për atë.

Por, po flasim për mbrojtjen e pellgjeve ose lumenjve që është shumë me rëndësi. Ne e kemi ato në rastet kur merret uji për përpunim, ku janë tek ato ujëra sipërfaqësore, vjen deri te ndotja e atij uji edhe ndotjet mund të jenë edhe në aspektin kimik, po edhe në aspektin e turbullirave që vinë.

Në aspektin kimik, ju e dini që disa lumenj ose disa...hajt ta marrim Ibër Lepencin se është sistem i hapur, ndikon që ato gjëra që për shembull, pesticidet dhe ato gjërat të vijnë pas pranvera dhe vjeshta, edhe ato kushtimisht duhet t'i kushtojmë rëndësi mbrojtjes këtyre sistemeve që janë për furnizim.

Kur folëm për këtë, elaborati mjedisor për zonat e mjedisit është shumë i rëndësishëm për ta shtjelluar këtë problem. Për atë arsye që tek objektet ndërtimore, sidomos për përpunimin e ujërave të ndotura te rastet që janë të ndjeshme të ashtuquajtur kur uji merret për pije prej një lumi apo prej një pusi që afër një lumi që është....në Fushë Kosovë, ajo ndikon jashtëzakonisht shumë. Prandaj, ky rasti im i ndjeshëm që e përmenda që nuk po e ceku, që ne e dimë që kategoritë kushtetuese neni 52 i Kushtetutës ...mjedisi si kategori kushtetuese edhe aty janë standardet, normat dhe rregulloret të cilat janë të plotësuara....

KRYETARI: Me shumë respekt, i nderuar, se jemi në fazën e mbylljes.

SIMON BALAJ: Po, vetëm ta them. Prandaj, shumë është me rëndësi që të mbrohen këto zona mjedisore, të mbrohen pellgjet, të mbrohen lumenjtë, ku kemi ato vende ku merret uji. Edhe shkarkimet e zeza duhet të bëhen me standarde, sidomos tek ato vende ku merret uji në pjesët me raste të ndjeshme. Rast i ndjeshëm do të thotë, uji që është aty mund të merret për pije, rasti jo i ndjeshëm, ose nonsensitive, nuk ka nevojë dhe nuk merret si ujë i pijes, prandaj edhe e shtjellova. Nuk kisha çka me thënë.

Tek rasti i Istogut atje dhe në rastet e Gurra e Hasan Agës, atje e kemi një segment që është i pambrojtur dhe aty ka ndikuar kontaminimi dhe kemi pasur probleme me disa përfaqësues atje, të cilët nuk na kanë lejuar ta mbrojmë atë segment.

Tek rasti i Istogut është uji i tepërt, që derdhet nëpër... provohet të derdhet, ai ujë i tepërt duhet të bëhet projekti, ose dizajni, ka ekzistuar si dizajn, është mundësi dhe ne kemi diskutuar me zotin Prebreza për këtë çështje teknike dhe besoj që shumë shpejt do të vijmë me një dizajn dhe një fizibilitet, i cili ka mundësi që çështjen e ujit të Klinës ta rregullojë. Faleminderit!

KRYETARI: Drejtoresha, pastaj e ka edhe kolegu fjalën dhe po e mbyllim.

HAJRIJE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit të gjithëve për kontributin në këtë takim, edhe pse kisha pasur dëshirë që më shumë të diskutojmë problemet sesa arritjet, në realitet, se probleme kemi. Vetë fakti që në Kosovë furnizimi me ujë në shumicën e komunave ende nuk është 24 orë brenda ditës, kemi hapësirë për përmirësim. Vetë fakti humbjet e ujit që i kemi, kemi hapësirë me u përmirësua. Vetë fakti i mosrealizimit të investimeve kapitale, moskoordinimi i investimeve kapitale, moskomunikimit të rregullt institucional, kemi hapësirë për përmirësim.

Nuk e mora asnjë përgjigje pse s'ka gatishmëri bashkëpunimi institucional, jemi duke e kërkuar që sa kohë, por s'ka. Unë uroj që së paku me shkrim të kemi përgjigje prej institucioneve dhe kompanive lidhur me sfidat e tyre, se unë jam në dijëni mjaft mirë që kompanitë kanë sfidat e

tyre. Por, asnjë s'na tha se ku është problemi i mosrealizimit të investimeve kapitale. Për rregullatorin e ujit është një problem shumë i madh. Në njërën anë krejt po themi tarifat janë të ulëta. Po, janë të ulëta, por nuk mund t'i rrisim, se ju s'po i zbatoni investimet kapitale.

Domethënë, ju po raportoni që me ato tarifa që i kemi aprovuar mjetet për shpenzime operative janë ende larg kufirit, mosrealizimi i investimeve kapitale na mbyll dyert dhe duart për të rritur tarifa. Nuk është në rregull tarifa e ujit me qenë 5 euro, 6 euro a 7 euro, kur ka nevojë për investime kaq të mëdha. Mirëpo, nuk mundemi ne me rritë tarifa pa u sigurua që ndërmarrja e ujësjellësit e ka kapacitetin, e ka vullnetin, e kupton seriozitetin e realizimit të këtyre investimeve. Kaq nga unë.

ABDULLAH DËRGUTI: Përshëndetje!

Unë jam Abdullah Dërguti, drejtor ekzekutiv në SHUKOS.

Nuk dua të marr shumë kohë, se u përmendën dhe u përsëritën disa tema.

Dua të ngre së paku dy tema, çështja e rivlerësimit të aseteve në ndërmarrje publike. Mendoj që kjo është një temë që do trajtim serioz prej vet Qeverisë, me kërkesë edhe të Kuvendit, që kjo të marrë një zgjidhje, sepse deri më tash nuk ka pasur një zgjidhje të duhur dhe kompanitë e ujësjellësve po atakohen përmes ATK-së, sepse kompanitë nuk kanë rivlerësim. Rivlerësimi i fundit që ka ndodhur, ka ndodhur në vitin 2007, në kohën kur ka ndodhur regionalizimi dhe Administrata Tatimore e ka marrë për bazë një kohë, pastaj nuk e ka marrë për bazë këtë regjistrim dhe ka mbetur pezull.

Tema e dytë ka të bëjë me Agjencinë Shtetërore të Informacionit, që i obligon kompanitë e ujësjellësve për të zarfuar faturat dhe për t'i dërguar faturat te konsumatorët përmes zarfeve. Kjo do të ketë një kosto shtesë, sipas meje është së paku katër-pesë milionë në vit. Besoj që është një kërkesë ndoshta tepër luksoze për kushtet në të cilat jemi për t'i mbrojtur të dhënat e faturave që do t'u dërgohen përmes zarfimit.

Edhe në pikën e tretë, që po dua ta diskutoj, çështja e tarifave. Ne jemi në një situatë kur duhet të diskutojmë, nëse duam zhvillim, apo duam mirëmbajtje të gjendjes. Nëse duam zhvillim ne duhet të ketë tarifa më të larta për t'u dhënë hapësirë ujësjellësve për të bërë investime më të mëdha vetanake, investime kapitale, dhe të kemi qëndrueshmëri më të lartë dhe qëndrueshmëri financiare. Nuk po e zgjas më shumë.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zoti Dërguti! Urdhëro, Driton!

DRITON HYSENI: E potencoi disa herë drejtoresha e ARU-së nevojën e bashkëpunimit. Po më intereson, sa je e kënaqur si ARU me bashkëpunimin me KRU-të? A janë bashkëpunuese? Mos po vërej se nuk ka relacione shumë të shëndosha e të mira në këtë drejtim, ARU me KRU-të?

HAJRIJE MORINA: Jo, unë asnjëherë nuk e përmenda bashkëpunimin me kompanitë rajonale të ujësjellësit. Kemi bashkëpunim të mirë. Jemi duke punuar bashkërisht për zhvillimin e sektorit.

Çështja ku ka nevojë për përmirësim është bashkëpunimi ndërinstitucional, institucioneve të sektorit të ujit. Ne kemi bërë përpjekje për të filluar menjëherë bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit, për shembull, raste konkrete po nisem. Hajde po i harmonizojmë edhe po ju jap informata se cilat resurse të ujit shfrytëzohen tek kompanitë e ujësjellësit? Informatat që ne i kemi me ua dhënë Ministrisë së Mjedisit, kemi kërkuar prej tyre dhe po i harmonizojmë emërtimet. Nuk ka pasur përgjigje. Ka nevojë bashkëpunimi.

Ndërmarrjet e ujësjellësit shfrytëzojnë resurset e ujit që nuk kanë leje ujore. Nuk kanë leje ujore! Ajo përgjegjësi e lejeve ujore, përpos që është e Ministrisë së Mjedisit, është edhe e komunave. Në këtë aspekt komunat nuk po kanë kapacitete me lëshua leje ujore. Kemi nevojë me u ulë e me bashkëpunua e me realizua këtë nevojë ligjore, që na e jep ligji. Domethënë, ata shfrytëzojnë resurse ujore dhe s'kanë leje ujore. Atë s'guxojnë as me i licencua në atë drejtim pa leje ujore.

Kemi nevojë bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë gjithashtu koordinimi i investimeve, përpos tjerash. Nuk mundemi me punua si shtete të veçanta. Duhet me u ulë, me bisedua e me folë, ku po i caktojmë prioritetet, kah po zhvillohet sektori, çfarë drejtimi po marrim dhe secili mandej sipas ligjit dhe mandatit që e ka të punojë, të punojmë bashkë.

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm, edhe një herë ju falënderoj për zëmbërshëm kontributin e dhënë të gjithëve.

Faleminderit! Shihemi në takimet e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*